

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

**RAPORTI VJETOR
2021**



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

PËRMBAJTJA

TERMINOLOGJIA	3
I. MESAZHI I KOMISIONERIT	7
II. E DREJTA E INFORMIMIT	9
II.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e programit të transparencës së autoriteteve publike.....	10
II.2 Transparenca në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe në administratën shtetërore	11
II.2.1 Raporti i monitorimit dhe indeksi i transparencës proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore	11
II.2.2 Raporti i monitorimit dhe indeksi i transparencës proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë	12
II.3 Rekomandime dhe Vendime për zbatimin e Programit të Transparencës	12
II.4 Trajtimi i ankesave dhe hetimi administrativ.....	13
II.5 Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit.....	15
II.6 Trajtimi i kërkesave për informacion dhe ankesave nëpërmjet portalit <i>e-Albania</i>	16
III. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE	19
III.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja.....	20
III.1.1Trajtimi i ankesave	20
III.1.2 Hetimet administrative	20
III.1.3 Hetimet administrative në zbatim të Rezolutës së Kuvendit	21
III.1.4 Hetime administrative për përhapjen e të dhënave personale	22
III.1.5 Përhapja e paligjshme e të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve.....	23
III.1.6 Përhapja e paligjshme për kategorinë e të dhënave personale <i>paga/targa</i>	25
III.2 Vendimmarrja	25
III.3 Regjistri i Njoftimeve	26
III.4 Transferimi ndërkombëtar	27
IV. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE	28
DHE GJYQËSORE	28
IV.1 Hartimi i akteve rregullatore	28
IV.1.1 Përafrimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me GDPR dhe Direktivën e Policisë.....	28
IV.1.2 Hartimi i projektaktit për përmirësimin e ligjit për të drejtën e informimit	29
IV.2 Dhënie mendimi për projektakte	30
IV.3 Proceset gjyqësore dhe ekzekutimi i vendimeve.....	30
V. PROJEKTI I BINJAKËZIMIT	31
V.1 Zbatimi i Projektit të Binjakëzimit	32
V.2 Ndikimi i Projektit të Binjakëzimit.....	38
VI. VEPRIMTARIA PËR BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR, STRATEGJITË NDËRSEKTORIALE, NDËRGJEGJËSIMIN DHE PROMOVIMIN	40
VI.1 Pjesëmarrja në forume dhe rrjete ndërkombëtare.....	40
VI.1.1 Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit.....	40

VI.1.2 Asambleja Globale e Privatësisë	41
VI.2 Bashkëpunime dypalëshe	42
VI.2.1 Bashkëpunimi me autoritetin homolog të Kosovës.....	42
VI.2.2 Bashkëpunimi me ambasadën britanike	42
VI.3 Strategji Ndërsektoriale	42
VI.3.1 Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015-2022 dhe Plani i ri i aktiviteteve 2018-2022.....	42
VI.3.2 Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit 2020-2023.....	42
VI.3.3 Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023 dhe Plani i Veprimit 2019–2023	43
VI.3.4 Kontrata e Suportit Buxhetor për Mirëqeverisjen 2020	43
VI.3.5 Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2018-2021	43
VI.4 Bashkëpunimi me shoqërinë civile.....	43
VI.5 Aktivitete të Zyrës së Komisionerit.....	44
VII.1 Menaxhimi i burimeve njerëzore	47
VII.1.1 Struktura organizative	47
VII.1.2 Zhvillimi i burimeve njerëzore	48
VII.2 Menaxhimi i buxhetit	48
VII.2.1 Të ardhurat dhe shpenzimet	48
VII.2.2 Të ardhurat nga sanksionet	49
VIII. PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE TË RAPORTIT TË KOMISIONIT EVROPIAN PËR SHQIPËRINË.....	50
IX. PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE DHE RAPORTIME	50
X. NIVELI I ZBATIMIT TË REZOLUTËS SË KUVENDIT 2021.....	50
XI. VIZIONI.....	50

SHKURTIME**TERMINOLOGJIA**

AKSHI	Agjencia Kombëtarë e Shoqërisë së Informacionit
AMS (AKSHI)	Sistemi i Menaxhimit të Aplikimit – Application Management System
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian – European Union
CFCU	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve -Central Finance and Contracting Unit
Direktiva 95/46 EC	Direktiva 95/46 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 24 Tetorit 1995 <i>“Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe qarkullimin e lirë të të dhënave të tilla”</i>
Direktiva e Policisë	Direktiva (BE) 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 27 prillit 2016 <i>“Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”</i>
Direktiva 2019/1024	Direktiva (BE) 2019/1024 <i>“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”</i>
EDPB	Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave – European Data Protection Board
GDPR	Rregullore (BE) nr. 2016/679 <i>“Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”</i> – General Data Protection Regulation
GPA	Asambleja Globale e Privatësisë – Global Privacy Assembly
ECDPA	Konferenca Evropiane e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave – European Conference of Data Protection Authorities

ICIC	Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit – International Conference of Information Commissioner
KE	Komisioni Evropian – European Council
KiE	Këshilli i Evropës – Council of Europe
Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale	Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar
Ligji për të drejtën e informimit	Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
Ligji për njoftimin dhe konsultimin publik	Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”
NjVV	Njësi të Vetëqeverisjes Vendore
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
Projekti i Binjakëzimit	Projekti i Binjakëzimit “Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me acquis të BE për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave”
Programi i Transparencës	Tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik, sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 7 të ligjit për të drejtën e informimit
REKPD	Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit
Rezoluta e Kuvendit	Rezolutë për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2020, miratuar datë 03.06.2021
SMSI	Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit
SIGMA	Mbështetje për Përmirësim të Qeverisjes dhe Menaxhimit - Support for Improvement in Governance and Management
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
Urdhër nr. 14/2015	Urdhri nr. 14, datë 22.01.2015 “Për miratimin e Programit model të Transparencës”

Urdhër nr. 211/2018	Urdhërin nr. 211, datë 10.09.2018 “Programi model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”
Urdhër nr. 187/2020	Urdhër nr. 187, datë 18.12.2020 “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”.
Urdhër nr. 188/2020	Urdhër nr. 188, datë 18.12.2020 “Për miratimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të rishikuar”
Udhëzim nr. 19/2012	Udhëzim nr. 19, datë 03.08.2012 mbi “Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi” ndryshuar me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2012
Udhëzim nr. 41/2014	Udhëzim nr. 41, datë 13.06.2014 “Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”
Udhëzim nr. 47/2018	Udhëzim nr. 47, datë 14.09.2018 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”
Udhëzim nr. 48/2018	Udhëzim nr. 48, datë 14.09.2018 “Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”
Udhëzim nr. 49/2020	Udhëzim nr. 49, datë 02.03.2020 “Për mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore”
Vendimi nr. 8/2016	Vendimi nr. 8, datë 31.08.2016 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”
VKM nr. 145/2018	Vendim i Këshillit të Ministrave nr.145/2018 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore “Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të drejtën e informimit””
Vendimi 2008/977/JHA	Kuadër Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/977/JHA i 27 nëntor 2008 “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuar në kuadrin e bashkëpunimit gjyqësor dhe të policisë në çështjet penale”

Vendimi i Kuvendit nr. 84/2020 Vendimi i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 84/2020 “Për disa shtesa e ndryshime të Vendimit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale””

Zyra e Komisionerit Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

I. MESAZHI I KOMISIONERIT

Etika, integriteti, përgjegjshmëria, transparenca dhe llogaridhënia janë shtyllat mbi të cilat bazohet kultura e respektimit të të drejtës për marrjen e dokumentacionit publik dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përmbushje të misionit të saj, veprimtaria e Zyrës së Komisionerit për vitin 2021 është orientuar drejt, për realizimin e paanshëm të mbikëqyrjes efektive të legjislacionit në fuqi. Nga ana tjetër, autoritetet publike dhe kontrolluesit publik e privat kanë një qasje gjithnjë e më bashkëpunuese, por ka ende rrugë të gjatë për arritjen e standardeve të kërkuara për garantimin e këtyre të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese. Po ashtu, për përmirësimin e performancës së tyre në ofrimin e shërbimeve cilësore, stafi ka vënë në çdo rast në dispozicion eksperiencën e tij.

Institucioni administroi 1354 ankesa nga qytetarët, një rritje prej mbi 30% në raport me vitin 2020. Shifra pasqyron, padyshim, ndërgjegjësimin e tyre për ushtrimin në praktikë të të drejtave. Por, analiza në këtë Raport Vjetor tregon se përgjegjësitë në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve janë ende në nivel të ulët dhe shpesh formale.

Rastet e cenimit dhe përhapjes masive të informacionit personal të qytetarëve treguan dobësi të theksuara të strukturave dhe sistemeve që i administrojnë ato. Epoka në të cilën jetojmë na imponon përshpejtimin e përpjekjeve, shtimin e resurseve dhe forcimin e masave për të adresuar problematikat e konstatuara në parandalimin e përsëritjes së tyre.

Miratimi i kuadrit të ri rregullator për mbrojtjen e të dhënave personale, përfaqëson një hop cilësor në këtë ndërmarrje modernizuese në kuadër të procesit të integritetit të vendit në BE. Në të njëjtën frymë, është vepruar edhe për ndryshimet në legjislacionin për të drejtën e informimit, për një administratë publike transparente dhe dinamike.

Zyra e Komisionerit beson në angazhimin e Këshillit të Ministrave dhe të Kuvendit për miratimin e tyre në një periudhë sa më të shpejtë. Paralelisht, mirëpret dhe nxit çdo iniciativë që mbështet zgjerimin e kapaciteteve dhe forcimin e funksioneve të saj mbikëqyrëse.

Votimi nga anëtarësia e ICIC për të qënë pjesë e Komitetit Ekzekutiv të kësaj organizate flet qartë për rolin e institucionit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Zyra e Komisionerit është e bindur se ky dimension i ri do të ndikojë që autoritetet publike shqiptare ta vlerësojnë transparencën si faktor pozitiv në komunikimin me publikun për të luftuar korrupsionin.

Së bashku përmirësojmë demokracinë dhe sundimin e ligjit, duke zhvilluar ekonominë dhe rritur mirëqënien e shoqërisë.

E DREJTA PËR INFORMIM

Kanë publikuar Programin
e Transparencës



VITI 2021

**374 Autoriteteve Publike
të monitoruara online**



Kanë publikuar kontaktet e
Koordinatorit



Kanë publikuar Regjistrin e Kërkesave
dhe Përgjigjeve



61 Autoritete Publike
ofrojnë shërbimin e
kërkesës/ankesës
në e-Albania

II. E DREJTA E INFORMIMIT

E drejta për informim është një nga të drejtat dhe liritë themelore të sanksionuara në Kushtetutën e Shqipërisë, zbatueshmëria e së cilës realizohet nga bashkëpunimi efektiv mes qytetarëve, autoriteteve publike dhe Zyrës së Komisionerit. Transparenca proaktive është rezultat i përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në legjislacionin e fushës, duke ndikuar që sot të qarkullojë një sasi më e madhe informacioni/dokumentacioni publik. Nga ana tjetër, një hallkë e rëndësishme në këtë proces është edhe roli i veçantë që luajnë organizatat e shoqërisë civile, veprimtaria e të cilave ka dhënë ndikim të konsiderueshëm në rritjen e llogaridhënies së autoriteteve publike.

Zbatimi i kësaj të drejte renditet në krye të ecurisë së parimeve të Reformës në Administratën Publike për fushën e llogaridhënies. Në raportin e monitorimit të SIGMA¹ për Shqipërinë për vitin 2021, vlera për treguesin “Qasja në informacionin publik” është në rritje, krahasuar me vlerësimin e mëparshëm të kryer në vitin 2017. Në lidhje me këtë progres, SIGMA ndalet ndër të tjera edhe në rolin e Zyrës së Komisionerit, duke vlerësuar pozitivisht përpjekjet e institucionit në promovimin e transparencës.



“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale, luan një rol kyç në monitorimin e standardeve të transparencës të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014. Në veçanti, Komisioneri vepron si një organ apelimi, i cili vlerëson mjetet juridike kundër refuzimit të aksesit në

informacion ose heshtjes administrative. Në shumicën e rasteve të shqyrtuara nga Komisioneri, aplikantët kanë marrë informacionin e kërkuar gjatë procedimit, i cili jep disa dëshmi të rolit të suksesshëm ndërmjetësues të institucionit. Siç tregon edhe anketa WeBER, një pjesë e madhe e popullsisë vlerëson pozitivisht përpjekjet e këtij institucioni në promovimin e transparencës”.

Gjatë vitit 2021 veprimet dhe aktivitetet e ndërmarra nga Zyra e Komisionerit u fokusuan në:

- ✓ monitorimin e detyrimit për zbatimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve;
- ✓ monitorimin e zbatimit të detyrimit për caktimin e koordinаторit për të drejtën e informimit dhe trajnimin e vazhdueshëm të tyre;
- ✓ shqyrtimin e ankesave në përputhje me afatet ligjore, duke përfshirë zhvillimin e inspektimeve apo seancave dëgjimore;
- ✓ dhënien e rekomandimeve në lidhje me Programin e Transparencës dhe Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve;
- ✓ përmbushjen e objektivave të parashikuara në strategjitë

¹ <https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf>

- ✓ ndërsektoriale, në të cilat Zyra e Komisionerit është pjesë;
- ✓ zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjëse me autoritetet publike dhe grupet e interesit;
- ✓ instalimin e REKPDİ në më shumë autoritete publike;
- ✓ bashkëpunimin me AKSHI për instalimin e sistemit AMS, për ofrimin e shërbimit të kërkesës për informacion publik dhe ankesës për mos dhënie informacioni, nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*;
- ✓ rolin aktiv të Zyrës së Komisionerit si anëtare e Komitetit Ekzekutiv të ICIC.

II.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e programit të transparencës së autoriteteve publike.

Programi i Transparencës përbën një nga instrumentet kryesore të ligjit për qasjen në informacionin publik, me qëllimin e nxitjes së integritetit, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike në raport me qytetarët dhe grupet e interesit. Për vitin 2021, Zyra e Komisionerit konstaton përmirësimin e transparencës proaktive në një numër më të madh autoritetesh publike, të cilat kanë publikuar informacione në rubrikat specifike të Programit të Transparencës. Ky progres vlerësohet se është rezultat i monitorimeve sistematike, inspektimeve pranë autoriteteve publike, zhvillimit të seancave dëgjimore me drejtues të këtyre institucioneve, dhënies së rekomandimeve dhe trajnimeve të vazhdueshme të koordinatorëve.


Gjatë vitit 2021, u monitoruan online 374 autoritete publike, nga të cilat 313 institucione qendrore dhe të varësisë, si dhe 61 NjVV.

Autoritetet publike qendrore dhe të varësisë u monitoruan në lidhje me publikimin e “*Programit të Transparencës të Rishikuar*”, sipas Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020, për të cilin u la si afat data 30 qershor 2021 për miratimin dhe publikimin në faqet e tyre zyrtare të internetit. Ndërsa, 61 NjVV u monitoruan në lidhje me publikimin e “*Programit Model të Transparencës për NjVV*”, sipas Urdhrit nr. 211, datë 10.09.2018. Të gjitha autoritetet publike u monitoruan, gjithashtu, për caktimin dhe publikimin e të dhënave të koordinatorit, si dhe publikimin e Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, sipas Urdhrit nr. 188, datë 18.12.2020.

Nga ky monitorim, rezultoi se 300 autoritete publike kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare Programin e Transparencës, 286 kanë të publikuar kontaktet e koordinatorit dhe 217 kanë të publikuar Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, në përputhje me përcaktimet e ligjore. Progresi për këto rezultate ka ardhur nga ndikimi i disa faktorëve, si:

- ✓ miratimi i Programit të Transparencës të rishikuar, i cili është më i strukturuar dhe autoritetet e kanë më të lehtë identifikimin e informacionit/dokumentacionit për t’u publikuar;
- ✓ inspektimet *ex-officio* të ushtruara pranë tyre për të verifikuar publikimin dhe vënien në zbatim të tij;
- ✓ përditësimin periodik të Programit të Transparencës dhe të Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve;

- ✓ trajnimin e vazhdueshëm të koordinatorëve dhe përfaqësuesve të autoriteteve publike.



Zyra e Komisionerit do të ndjekë këtë qasje aktive edhe për ato autoritete publike që nuk i kanë përmbushur ende detyrimet ligjore.

II.2 Transparenca në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe në administratën shtetërore

Gjatë vitit 2021, me qëllim matjen e transparencës proaktive, Zyra e Komisionerit zhvilloi dy monitorime në kategori të ndryshme autoritetesh publike, për të cilat u hartuan raportet respektive.



II.2.1 Raporti i monitorimit dhe indeksi i transparencës proaktive të njësive të vetëqeverisjes vendore

Monitorimi i parë u zhvillua për verifikimin e nivelit të transparencës proaktive të 61 NjVV për periudhën shtator-dhjetor 2021. Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 5

treguesve, të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të transparencës proaktive të tyre, të cilët janë si më poshtë:

- publikimi i Programit të Transparencës;
- përditësimi i Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve;
- publikimi i të dhënave të koordinatorit;
- publikimi i të dhënave të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik;
- publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar 2021.

Në konkluzion të këtij monitorimi, vërehet një rritje e transparencës proaktive në krahasim me vitin 2020, veçanërisht në 3 indikatorët e parë të metodologjisë dhe konkretisht: “*publikimi i Programit të Transparencës*”, “*përditësimi i Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve*” dhe “*publikimi i të dhënave të koordinatorit*”. Rezultatet e monitorimit tregojnë, se 57 NjVV, ose 93% e tyre, kanë të publikuar Programin e Transparencës dhe nga këto, 55 kanë të publikuar informacionin/dokumentacionin plotësisht ose pjesërisht. Fokus i punës së Zyrës së Komisionerit do të vijojë të jetë monitorimi më i detajuar i rubrikave të Programit të Transparencës së këtyre autoriteteve publike, në lidhje me plotësimin e detyrimeve sipas nenit 7 të ligjit.

II.2.2 Raporti i monitorimit dhe indeksi i transparencës proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë

Monitorimi i dytë u zhvillua për verifikimin e nivelit të transparencës proaktive të 100 institucioneve qendrore (kryeministria e ministritë dhe institucione të tyre të varësisë; institucione të pavarura; gjykata, sistemi i prokurorisë, universitete, shoqëri anonime ku shteti zotëron pjesën më të madhe të aksioneve) për periudhën shtator-dhjetor 2021. Metodologjia e përdorur i referohet 5 treguesve, të cilët janë si më poshtë:

- publikimi i Programit të Transparencës;
- përditësimi i Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve;
- publikimi i të dhënave të koordinatorit;
- publikimi i të dhënave të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik;
- publikimi i të dhënave për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin 2021.

Zyra e Komisionerit konstaton se në krahasim me monitorimin e kryer në vitin 2020, autoritetet publike qendrore dhe të varësisë kanë një performancë më të mirë në publikimin e informacionit/dokumentacionit në Programin e Transparencës në faqet e tyre zyrtare. Të dy këto raporte gjenden të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Komisionerit në lidhjen <https://www.idp.al/raporte-monitorimi-2021/>.

II.3 Rekomandime dhe Vendime për zbatimin e Programit të Transparencës

Në fillim të vitit 2021, Zyra e Komisionerit përfundoi procesin e hetimit administrativ, të nisur në dhjetor të vitit 2020, për ato autoritete publike qendrore dhe të varësisë për mos publikimin e Programit të Transparencës. Në përfundim, Komisioneri doli me 4 Vendime me sanksion

administrativ dhe me 1 Rekomandim për nëpunësit publik përgjegjës për zbatimin e këtij detyrimi ligjor.


Nga monitorimet e kryera faqeve zyrtare të internetit të NjVV për të verifikuar publikimin e Programit të Transparencës, sipas Urdhrit nr. 211/2018, rezultoi se disa prej tyre edhe pse e kishin të publikuar formalisht këtë instrument, kishin mangësi në publikimin e informacionit të detyrueshëm në rubrikat e tij. Komisioneri konkludoi me 35 Rekomandime për këto autoritete publike. Me përfundimin e afatit të parashikuar në këto akte, u zhvilluan 20 inspektime në NjVV për verifikimin e përmbushjes së rekomandimeve. Nga inspektimet e kryera, Zyra e Komisionerit konstatoi përmbushjen e detyrimit për publikimin e Programit të Transparencës nga 19 NjVV, ndërkohë 1 nuk e kishte plotësuar këtë detyrim. Për këtë arsye, Komisioneri u shpreh me Vendim me sanksion administrativ për nëpunësin publik përgjegjës për zbatimin e këtij detyrimi ligjor.

Në përfundimin të afatit për publikimin e Programit të Transparencës, sipas Urdhrit nr. 187/2020, për autoritetet publike qendrore dhe varësisë, Zyra e Komisionerit filloi procedurën e inspektimit administrativ në 5 institucione, të cilat nga monitorimi paraprak nuk kishin marrë asnjë masë për plotësimin e këtij detyrimi. Në përfundim të procedurës së hetimeve administrative këto autoritete plotësuan detyrimin për publikimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve.


II.4 Trajtimi i ankesave dhe hetimi administrativ

Zyra e Komisionerit, për vitin 2021, administroi 992 ankesa, si dhe vijoi me shqyrtimin e 44 ankesave të mbartura nga viti 2020 (**në total 1036**). Institucioni konstaton një tendencë gjithnjë në rritje të numrit të ankesave nga qytetarët, çka nënkupton forcimin e besimit të tyre në veprimtarinë dhe rezultatet e punës së institucionit.


Nga totali prej 1036 ankesash, për 698 prej tyre informacioni/dokumentacioni i kërkuar është vënë në dispozicion të ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ. Ndërkaq, 158 ankesa kanë rezultuar jashtë objektit, 33 jashtë afatit, 36 të paplota, 19 të refuzuara bazuar në kufizimet e së drejtës për informim në përputhje me nenin 17 të ligjit dhe 2 ankesa janë pezulluar. Për 41 ankesa Komisioneri u shpreh me Vendim. 49 ankesa u mbartën për shqyrtim në vitin 2022.



Nga numri i ankesave të administruara, rezulton se për 336 prej tyre objekt ka qenë refuzimi i dhënies së informacionit nga 61 NjVV. Ndërkohë, pjesa tjetër prej 656 ankesash, me të njëjtin objekt, rezulton ndaj 313 autoriteteve të tjera publike. Nëse krahasojmë peshën specifike të ankesave ndërmjet këtyre dy kategorive të autoriteteve publike, konstatohet se ato ndaj NjVV mbajnë peshën kryesore, sikurse paraqitet në grafik.



Për ankesat e depozituara u zhvilluan 23 inspektime pranë autoriteteve publike, si dhe 52 seanca dëgjimore. Në përfundim, Komisioneri doli me 41 Vendime, prej të cilave 36 urdhërimi për dhënie informacioni, 1 rrëzimi, 2 mospranimi dhe 2 me sanksion administrativ. Për një transparencë më të lartë me publikun, Zyra e Komisionerit publikon në portalin www.pyetshtetin.al listën e ankesave të administruara, e cila mund të konsultohet lehtësisht nga qytetarët dhe grupet e interesit. Referuar të dhënave, për aq sa mund të indentifikohen, ankesat e paraqitura janë grupuar në tre kategori: nga qytetarë, nga organizata të shoqërisë civile dhe nga gazetarë/media investigative.



Nga shqyrtimi i ankesave, Zyra e Komisionerit konstaton se ato kanë patur në fokus dhënien e informacionit në lidhje me kontratat publike (koncensione, prokurime, etj), procesin e rindërtimit pas tërmeteve të vitit 2019, si dhe veprimtarinë e autoriteteve publike të sektorit shëndetësor. Ndër problematikat më të rëndësishme përmendim:

- i. *paqartësi nga ana e autoriteteve publike lidhur me konceptin e konfidencialitetit në kontratat publike, i trajtuar jo në përputhje me parashikimet e nenit 17 të ligjit. Në kontratat publike shpesh parashikohen dispozita konfidencialiteti për informacionin/dokumentacionin që lidhet me to dhe në rast të mos zbatimit të tyre, parashikohen sanksione ndaj autoritetit publik. Për të shmangur këtë problematikë, është e nevojshme që në klauzolat e konfidencialitetit të qartësohen se mbi cilën pjesë të informacionit shtrihen, duke patur parasysh që në asnjë rast nuk mund të mbizotërojnë mbi parashikimet e ligjit për të drejtën për informim, përveç kur konkurrohet me një parashikim tjetër ligjor;*

- ii. *tendencë e kërkesve për të përdorur për çështje/praktika administrative me karakter individual, dispozitat e ligjit përtej objektit dhe qëllimit të tij, të tilla si: dokumentacion lidhur me lejet e ndërtimit, pasojat e tërmeteve, pronësinë, procedura rekrutimi, etj;*
- iii. *informacioni i kërkuar shtrihet në periudha të gjata kohore (mbi 10 vjet), gjë që ka vështirësuar kthimin e përgjigjes brenda afatit ligjor;*
- iv. *janë shtuar ankesat nga ana e avokatëve për aksesimin e dokumentacionit të njehësuar, i cili shërben si provë në procese gjyqësore, duke anashkaluar në këtë mënyrë Ligjin për Avokatinë apo Kodin e Procedurave Administrative;*
- v. *kërkesat fillestare kanë konsistuar në pyetje apo prononcime drejtuar autoriteteve publike për çështje të caktuara, të cilat tejkalojnë qëllimin e njohjes me informacionin/dokumentacionin publik në zbatim të ligjit;*
- vi. *vijon ndryshimi i shpeshtë i koordinatorit, caktim i tyre në nivel ekzekutiv apo të ulët drejtues, si dhe aksesit i kufizuar që kanë në strukturat e tjera të autoritetit publik. Për shkak të rolit dhe përgjegjësisë që koordinatori ka në trajtimin e kërkesave për informacion, Zyra e Komisionerit në mënyrë të vazhdueshme orienton autoritetet publike të marrin masa për forcimin e pozitës së tij. Vlerësohen pozitive rastet kur pozicioni i koordinatorit është i dedikuar (sipas këtij orientimi kanë vepruar disa bashki, të cilat tashmë e kanë pjesë të strukturës së tyre këtë pozicion). Nga ana tjetër, problematikat e konstatuara për veprimtarinë e koordinatorit janë propozuar për t'u adresuar nëpërmjet ndryshimeve në ligjin për të drejtën e informimit.*

Për të gjitha këto çështje, Zyra e Komisionerit është e angazhuar të zhvillojë trajnime me të gjitha nivelet e administratës publike për forcimin e integritetit dhe llogaridhënies, me fokus, rritjen e transparencës proaktive. Trajnime të dedikuara parashikohet të zhvillohen edhe me qytetarë apo grupe interesi, për t'i ndërgjegjësuar në zbatimin e të drejtave të tyre në praktikë, në lidhje me ndryshimin midis kërkesës për informacion publik dhe trajtimit të praktikave individuale në përmbushje të detyrave funksionale të institucioneve.


II.5 Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit

Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit është një sistem që mundëson qasje më të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe grupeve të interesit në informacion publik, duke shmangur burokracitë. Nëpërmjet REKPDI garantohet edhe e drejta e ankesës pranë Zyrës së Komisionerit, në rast të refuzimit të dhënies së informacionit nga autoritetet publike. Sistemi garanton gjurmimin në kohë reale të procesit të trajtimit të kërkesës/ankesës.

Në fund të vitit 2020, ky regjistër ishte i instaluar në 59 autoritete publike. Përgjatë vitit 2021, Zyra e Komisionerit ka kërkuar nga 53 institucione instalimin e REKPDI, detyrim të cilin e përmbushën vetëm 12 autoritete. Duke konstatuar ecurinë e ngadaltë në shtrirjen e këtij sistemi, Zyra e Komisionerit mundësoi me fondet e veta buxhetore instalimin e tij edhe për 24 autoritete të tjera publike. Në fund të vitit, gjithsej, 95 institucione kanë funksional këtë

sistem dhe vijon puna për rritjen e këtij numri. Paralelisht, janë trajnuar koordinatorët për mënyrën e përdorimit të tij.

Për vitin 2021, nga 95 autoritete publike që e kanë të instaluar REKPDI, numri i kërkesave për informacion publik të trajtuara është 382. Ndërsa, numri i ankesave të depozituara në Zyrën e Komisionerit është 49.



II.6 Trajtimi i kërkesave për informacion dhe ankesave nëpërmjet portalit e-Albania

Zyra e Komisionerit po bashkëpunon me AKSHI për instalimin e sistemit AMS, për ofrimin e shërbimeve të “kërkesës për informacion publik” dhe “ankesës për mos dhënie informacioni” nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania. Këto shërbime, tashmë, ofrohen për qytetarët nga 61 autoritete publike qendrore dhe ato të vetëqeverisjes vendore, duke u garantuar qytetarëve një alternativë tjetër për të ushtruar të drejtën për të aksesuar informacionin publik. Kjo nismë përmbush një nga rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit, përveç se është një detyrim i parashikuar nga neni 14 i ligjit. Duke marrë në konsideratë faktin se kemi të bëjmë me një risi, po zhvillohen trajnime për njohjen e koordinatorëve me modalitetet e përdorimit të këtij sistemi.

Kërkesë për informacion publik

Kërkesa i drejtohet një autoriteti publik për të marrë informacion publik. Informacion publik, bazuar në pikën 2 të nenit 2 të Ligjit nr.119/2014, është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Kërkesa për informim i drejtohet koordinatorit për të drejtën e informimit pranë autoritetit publik.

Neni 14 i ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" parashikon se "Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

Dokumentacioni i nevojshëm
 Dokumentet që duhet të ngarkohen nga aplikanti:
 - Dokumente që mbështesin kërkesën e aplikantit.

Hapat e procedurës

Më shumë se 7 vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 119/2014, fusha e drejtës për informim ka njohur evoluim të shpejtë, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor. Zyra e Komisionerit konstaton një prirje në rritje të interesit të qytetarëve për të kërkuar informacion/dokumentacion publik, paralelisht me atë të grupeve të interesit. Për shoqërinë shqiptare është e rëndësishme kjo qasje, si një nga elementët kryesore për të forcuar funksionimin e demokracisë dhe sundimin e ligjit.

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

PËRHAPJA MASIVE E TË DHËNAVE PERSONALE PËR KATEGORITË




Zgjedhës
Paga
Targa

HETIME ADMINISTRATIVE

Urdhër
Rekomandime
Vendime

ANKESA



VITI 2021
46
HETIME
ADMINISTRATIVE

33 KONTROLLUES
PUBLIK
13 KONTROLLUES
PRIVAT



SHËNDETËSI
ARSIM
TELEKOMUNIKACION
INSTITUCIONE PUBLIKE
TREGTIM I DREJTPËRDREJTË

III. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Përpunimi i të dhënave personale është motori jetik për zhvillimin ekonomik të një shoqërie. Rritja e kulturës për mbrojtjen e privatësisë garanton zbatimin e kësaj të drejte dhe lirie themelore të individit në një mjedis ku digjitalizimi po mbizotëron gjithnjë e më shumë.

Zyra e Komisionerit, gjatë vitit 2021, paralelisht me detyrimet monitoruese dhe mbikëqyrëse në zbatim të ligjit, u fokusua dhe në veprimtarinë e sektorëve të tillë si: shëndetësia, arsimi dhe marketingu i drejtpërdrejtë. Përzgjedhja e tyre u diktua nga sasia shumë e madhe e të dhënave personale dhe sensitive që përpunohen dhe ndikimit që këta sektorë kanë në privatësinë e qytetarëve, duke marrë në konsideratë faktin se pandemia Covid-19 ende vijon të ndikojë rrjedhën normale të jetës. Vëmendje iu është kushtuar, sidomos, verifikimit të masave tekniko-organizative në garantimin e një procesi përpunimi të sigurt të të dhënave personale nga këta kontrollues.

Sjellja në vëmendje për çdo pale të interesuar në lidhje me disa aspekte të “telepunës”, ndikuar nga pandemia, angazhoi Zyrën e Komisionerit në hartimin e “Udhëzuesit për përpunimin e të dhënave personale gjatë telepunës në kuadër të masave kundër COVID-19”. Kjo nismë adreson problematika në marrjen e masave shpesh lidhur me sigurinë e të dhënave nga kontrollues publik e privat gjatë aplikimit për herë të parë ose rritjen e përdorimit të mjeteve të “telepunës”.

Rastet e publikimit të të dhënave personale të shtetasve në një shkallë të gjerë, të ndodhura gjatë këtij viti, përbëjnë shkeljen më të rëndë të jetës private dhe të së drejtës së qytetarëve për mbrojtjen e këtyre të dhënave. Këto ngjarje angazhuan institucionin të ndërmerte me përgjegjshmëri zhvillimin e hetimeve administrative *ex-officio* në lidhje me to. Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021² vlerësoi rolin e Zyrës së Komisionerit dhe nxit autoritetet përgjegjëse për zbatimin e vendimmarrjes së saj.



Albania 2021 Report


“Zyra e Komisionerit ka ndërmarrë një hetim administrative kryesisht pas rrjedhjes së të dhënave personale sensitive, përfshirë preferencat politike, që u zbulua gjatë fushatës së zgjedhjeve të përgjithshme të 25 prillit. Zyra e Komisionerit publikoi raportin e saj, i cili përmban gjetje të shkeljes së rregullave të mbrojtjes së të dhënave. Zyra e Komisionerit i ka drejtuar rekomandime autoriteteve përkatëse për përditësimin e protokolleve të sigurisë dhe kufizimit të aksesit dhe përdorimit të të dhënave të bazave të të dhënave shtetërore. Një vendim është marrë edhe për vendosjen e një sanksioni për autoritetin tatimor për refuzim bashkëpunimi. Këto rekomandime duhen zbatuar me shpejtësi, pa cenuar procedimet e tjera të autoriteteve kompetente që kanë për qëllim vlerësimin e integritetit të procesit zgjedhor”.

² https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

III.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja

III.1.1 Trajtimi i ankesave


Zyra e Komisionerit, gjatë vitit 2021, administroi 362 ankesa nga qytetarët. Për pjesën më të madhe të tyre, rreth 60%, objekt ishte mosrespektimi i të drejtës për akses, ndërsa ato për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale përbëjnë mbi 25% të totalit dhe pjesa e mbetur, ka lidhje me marketingun e drejtpërdrejtë.



Zyra e Komisionerit ka ndjekur qasje proaktive në veprimtarinë e saj mbikëqyrëse si në aspektin parandalues, ashtu edhe në atë të plotësimit të detyrimeve ligjore, duke u përqendruar te masat tekniko-organizative dhe specifike, në Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit. Çdo kontrollues e përpunues mban përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e garantimit të kësaj të drejte themelore të qytetarëve në mënyrë konstante. Nga ana tjetër, zhvillimi ekonomik u dikton atyre t'i kushtojnë vëmendje përmirësimit dhe modernizimit teknologjik, me qëllim minimizimin e risqeve në përhapjen/cenimin e të dhënave personale.

III.1.2 Hetimet administrative

Gjatë vitit 2021 u realizuan 46 hetime administrative. Nga këto, 12 janë zhvilluar për verifikimin e ankesave të qytetarëve dhe 34 me iniciativën e Zyrës së Komisionerit. 33 procedura hetimi administrativ janë zhvilluar në kontrollues publik dhe 13 të tjera, në kontrollues privat. E gjithë kjo veprimtari është realizuar pranë ambienteve të kontrolluesve, duke bërë të mundur verifikimin e provave dhe situatës konkrete në raport me procesin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale.



SEKTORËT	SHËNDETËSIA
E	ARSIMI
HETIMIT	TELEKOMUNIKACIONI
ADMINISTRATIV	KONTROLLUES PUBLIK
	TREGTIMI I DREJTPËRDREJTË

III.1.3 Hetimet administrative në zbatim të Rezolutës së Kuvendit

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit, Zyra e Komisionerit u angazhua në zhvillimin e 33 procese hetimi administrativ në kontrollues publik e privat që për shkak të veprimtrarisë së tyre përpunojnë të dhëna personale të qytetarëve në sasi shumë të mëdha.

Në **sektorin e shëndetësisë** u kryen 13 inspektime për mbikëqyrjen e zbatimit të detyrimeve ligjore, me fokus, proceset përpunuese të të dhënave personale gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. Për gjetjet e konstatuara, Komisioneri u shpreh me Rekomandimin unifikues për 15 institucione të kujdesit shëndetësor, për të adresuar problematikat që kanë të bëjnë kryesisht me masat tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave, të parashikuara në Udhëzimet nr. 47/2018, 48/2018 dhe 49/2020. Po ashtu, Komisioneri doli edhe me 10 Rekomandime dhe 3 Vendime që korrespondojnë me 4 sanksione administrative.

Në **sektorin e arsimit** u zhvilluan 13 inspektime, kryesisht në kontrollues publik, për mbikëqyrjen e zbatimit të detyrimeve ligjore, me fokus, përpunimin e të dhënave personale gjatë procesit të mësimdhënies virtuale në periudhën e pandemisë Covid-19. Edhe për këtë sektor, në fokus ishte kontrolli i masave tekniko-organizative për garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale. Në përfundim, Komisioneri doli me 9 Rekomandime dhe 4 Vendime që korrespondojnë me 12 sanksione administrative.

Në **sektorin e tregtimit të drejtpërdrejtë** u ndërmorrën 7 inspektime, në kontrollues privat, kryesisht dhe mbi bazë ankese, objekt i të cilave ishin thirrjet/mesazhet promocionale të padëshiruara. Në përfundim, Komisioneri doli me 2 Rekomandime dhe 4 Vendime që korrespondojnë me 14 sanksione administrative.

Nga kjo veprimtari mbikëqyrëse, Zyra e Komisionerit konstatoi problematika serioze në drejtim të marrjes së masave të domosdoshme tekniko-organizative për kryerjen e proceseve përpunuese, me ndikim thelbësor për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale.

- Mungojnë elementë të infrastrukturës së nevojshme për ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e SMSI, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 47/2018 në harmoni me Udhëzimin nr. 48/2018.

- Për sektorin shëndetësor, konstatohet mungesa e rregullave për nivelet e aksesit në të dhënat personale (sensitive) të pacientëve, specifikisht, të atyre të prekur nga virusi Sars-Cov-2.
- Ka mungesë të angazhimit të kontrolluesve për sa i përket domosdoshmërisë së trajnimit të vazhdueshëm të punonjësve që kanë akses në të dhënat personale dhe mbikëqyrin proceset përpunuese. Zyra e Komisionerit vlerëson se duhet të konsolidohen praktikat e punës të personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale në raport me legjislacionin specifik që rregullon veprimtarinë e kontrolluesve.
- Kontrolluesit nuk zbatojnë detyrimin për informim të subjekteve të të dhënave (qytetarëve), veçanërisht, në lidhje me kohëzgjatjen e procesit, si dhe për ushtrimin e të drejtave të tyre (akses, bllokim, korrigjim, fshirje, etj.).
- Është konstatuar se nuk respektohen parimet e mjaftueshmërisë dhe kohëzgjatjes së ruajtjes së të dhënave personale gjatë zhvillimit të procesit mësimor online.
- Publikimi i fotove/videove të nxënësve të arsimit parauniversitar në rrjetet sociale të marra gjatë mësimi apo aktiviteteve kulturore e sportive, kryhet në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e tyre. Zyra e Komisionerit në veprimtarinë e saj ndërgjegjësose me institucionet arsimore ka sugjeruar gjithnjë marrjen e masave të duhura në këtë drejtim.
- Kontrollues publik dhe privat, në përdorimin e të dhënave personale për shkak të veprimtarisë së tyre, nuk respektojnë masat e sigurisë në këtë proces, veçanërisht, në drejtim të komunikimeve elektronike nga adresat individuale të punonjësve.
- Për sektorin e tregtimit të drejtpërdrejtë konstatohet se siguri i të dhënave personale është bërë në rrugë jo ligjore dhe nuk respektohet kriteri i dhënies së pëlqimit sipas dispozitave rregullatore.
- Kontrolluesit nuk respektojnë detyrimin për njoftim dhe përditësimin e tij, sa herë që përpunohen kategori apo sasi të reja të dhënash personale.

Të njëjtat problematika me sa më sipër, u konstatuan edhe në procesin mbikëqyrës për trajtimin e ankesave të qytetarëve, ku veçojmë, mosrespektimin e dispozitave të legjislacionit në fuqi për rastet e delegimit të proceseve përpunuese.

III.1.4 Hetime administrative për përhapjen e të dhënave personale

Zyra e Komisionerit, nisur nga shkalla jashtëzakonisht e gjerë e përhapjes së të dhënave personale të qytetarëve të publikuara në media dhe/ose nëpërmjet mekanizmave të tjerë të komunikimeve elektronike, u angazhua menjëherë në zhvillimin e hetimeve *ex-officio*, kombinuar kjo edhe me trajtimin e ankesave individuale. Këto ngjarje, të cilat në terminologjinë e mbrojtjes së të dhënave njihen si “*personal data breach*”, përbëjnë cenim shumë të rëndë të jetës private të shtetasve. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se ushtrimi i lirisë së shprehjes dhe të shtypit, kur në objekt ka të dhëna personale, para së gjithash, duhet realizuar duke mbajtur në konsideratë faktin se “*interesi i lartë publik*”, dallon thelbësisht nga “*interesi për publikun*”. Në këtë kontekst, hetimet administrative u fokusuan në:

- ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale për 910 mijë shtetas/zgjedhës;
- ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale për “nëpunës/punonjës” në sektorin publik dhe privat;
- ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale për “pronarë automjesh”.

III.1.5 Përhapja e paligjshme e të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve

Më datë 11.04.2021, në portalin *Lapsi.al* u publikua lajmi me titull “Ekskluzive/Si na monitoron Rilindja nr e telefonit, nr ID, vendet e punës, të dhënat konfidenciale për 910 mijë votues të Tiranës”, i cili gjendej në lidhjen: <https://lapsi.al/2021/04/11/ekskluzive-si-na-monitoron-rilindja-nr-e-telefonit-nr-id-vendet-e-punes-te-dhenat-konfidenciale-per-910-3-mije-votues-te-tiranes/>. Në të, ky kontrollues, bën me dije se ka siguruar një databazë me të dhëna personale të mbi 910 mijë qytetarëve të Bashkisë Tiranë. Zyra e Komisionerit ka ardhur në posedim të kësaj baze të dhënash (*data_tirana_2021_Backup_Backup.accdb*), e cila përmbante edhe informacione sensitive në kuptim të pikës 4, të nenit 3 të ligjit.

Në lidhje me rastin, u iniciuan hetime administrativ pranë kontrolluesve Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Partia Socialiste e Shqipërisë, Partia Bindja Demokratike dhe në portalin *Lapsi.al*. Paralelisht, është konstatuar një përhapje masive dhe e paligjshme e kësaj baze të dhënash edhe nëpërmjet faqeve në internet www.patronazhisti.com dhe <https://adfrehasdghf.web.app/>. Zyra e Komisionerit iu drejtua Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për bllokimin e menjëhershëm të këtyre domain-eve, si dhe fillimin e procedimit ligjor ndaj personave që zotërojnë/posedojnë këto faqe interneti. Për secilin prej kontrolluesve u zhvilluan inspektime në terren të shtrira në kohë, për shkak të kompleksitetit të kësaj çështjeje.

Përgjatë procesit të hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit konstatoi në mënyrë të përmblendhur problematikat e mëposhtme:

- Megjithëse autoriteti kontribuon në vazhdimësi për rritjen e ndërgjegjësimit dhe asiston kontrolluesit publik, ende ka një nivel të pamjaftueshëm njohurish dhe mungesë të qartë vullneti për të përmbushur dhe respektuar dispozitat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, në funksion të ushtrimit të detyrave të tyre.
- Konstatohet se kontrolluesit gjatë përpunimit të të dhënave personale nuk parashikojnë në mënyrë konkrete, të gjitha proceset përpunuese, në dokumente të mirëfillta rregullatore që garantojnë ruajtjen, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve, sipas akteve ligjore në fuqi.
- Konstatohet mungesë vëmendjeje dhe përpjekjesh në drejtim të marrjes, në përgjithësi, të masave tekniko-organizative, të cilat synojnë të garantojnë, veçanërisht, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Në lidhje me këtë aspekt, vërehet mungesë koordinimi dhe bashkëpunimi midis institucioneve, ku palët vijojnë të shmangin përgjegjësinë nga vetja, duke ia ngarkuar atë njëra-tjetrës.

- Konstatohet se nevojiten përpjekje të vazhdueshme në aspektin e garantimit të sigurisë teknike dhe organizative të të dhënave, si dhe krijimit, mirëmbajtjes dhe administrimit të SMSI, sipas parashikimeve të Udhëzimeve nr. 47/2018 dhe 48/2018. Po ashtu, mbetet e një rëndësie themelore domosdoshmëria për të modernizuar infrastrukturën dhe aktet rregullatore që lidhen me sistemet dhe bazat e të dhënave.
- Konstatohet dhënie aksesit e pakufizuar dhe pa iu referuar një detyrimi ligjor ose në tejkalim të një parashikimi ligjor, mbi sasinë e informacionit ku duhet të lejohet aksesit.
- Konstatohet se ka vështirësi në menaxhimin e burimeve të teknologjisë së informacionit, si dhe mungesa në strategji, plane dhe strukturë të pavarur për të kryer këtë funksion në zbatim të masave rregullatore të SMSI.
- Konstatohen mangësi në adresimin e elementeve, detyrimeve dhe garancive të sanksionuara në legjislacion për sa i përket marrëdhënieve kontraktore, që kontrolluesit lidhin me palë të treta (në cilësinë e përpunuesit) për delegimin e shërbimeve të ndryshme, ku në thelb të tyre ka edhe përpunim të të dhënave personale.
- Konstatohet mosrespektim sistematik i legjislacionit nga të gjithë kontrolluesit mbi përgjegjësinë e tyre për të kërkuar mendime/opinione nga Zyra e Komisionerit për projekt-akte, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me fushën e të dhënave personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga këta kontrollues, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë.

Gjetjet e evidentuara në këto hetime administrative trajtohen në mënyrë të detajuar në *“Relacionin e hetimit administrativ për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale të shtetasve”*, nr. 1399 prot., datë 19.08.2021.

Vlen të theksohet fakti, se këto problematika janë konstatuar edhe më parë nga Zyra e Komisionerit, të cilat gjenden të reflektuara në Raportin³ e hartuar në kuadër të Rezolutës, datë 21.05.2020, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë *“Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2019”*.

- ✓ Në përfundim të kësaj veprimtarie, Komisioneri u shpreh me 3 Rekomandime dhe me 1 Vendim, që korrespondon me një sanksion administrativ. Për të gjithë kontrolluesit e përfshirë në këto hetime administrative, Zyra e Komisionerit nxiti marrjen e masave për: hartimin e strategjisë për SMSI, bazuar në parimet e sigurisë TIK (konfidencialiteti, integriteti, disponueshmëria, besueshmëria), sipas standardit ISO/IEC 27001;
- ✓ ngritjen e strukturave monitoruese për SMSI dhe përmirësimin e vazhdueshëm të objektivave të sigurisë;
- ✓ trajnimin e vazhdueshëm të stafit në lidhje me standardet ndërkombëtare;
- ✓ projektimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të sigurisë së rrjetit dhe enkriptimi i të dhënave gjatë transferimit të tyre në të gjitha kanalet (HTTPS, IPSec, TLS, PPTP, SSH);
- ✓ krijimin e një regjistri të plotë të pajisjeve (aseteve) TIK në përdorim, duke analizuar rëndësinë e të dhënave personale që këto asete ruajnë dhe përpunojnë;

³ <https://www.idp.al/wp-content/uploads/2022/01/RAPORT-TIK.pdf>

- ✓ centralizimin e të gjitha aseteve me anë të të cilave kryhet përpunim i të dhënave personale dhe monitorimi periodik i tyre, si dhe zbatimin dhe monitorimin e politikave për instalimin, aksesin dhe përditësimin e pajisjeve (aseteve);
- ✓ zbatimin e politikave për kontrolle (fizike/teknike) dhe kufizimin e përdoruesve sipas nevojave për punë, si dhe auditimin periodik të sistemeve dhe rrjetit bazuar mbi matricën e akseseve. Përdorimin e Multifactor Authentication (MFA) në strukturat kritike dhe ato që përmbajnë të dhëna sensitive;
- ✓ kontrollin nëpërmjet skanimeve, në mënyrë sistematike, të infrastrukturës kritike;
- ✓ zbatimin e një plani për vazhdimësinë e sigurisë së informacionit (disaster recovery plan) dhe testimin në mënyrë periodike të të gjithë komponentëve të tij;
- ✓ vlerësimin e përputhshmërisë së SMSI me standardin ISO/IEC 27001, në përputhje me Udhëzimin nr. 48/2018, nëpërmjet auditimit periodik dhe mekanizmit të certifikimit për këtë qëllim.


III.1.6 Përhapja e paligjshme për kategorinë e të dhënave personale paga/targa

Duke nisur nga data 22.12.2021, Zyra e Komisionerit u informua për shpërndarjen masive të të dhënave personale nga një databazë, ku ndër të tjera, përfshihen pagat e qytetarëve të punësuar në sektorin publik dhe atë privat për *muajin janar 2021* për 637137 individë, nëpërmjet platformës së komunikimit “WhatsApp”. Në ditët që pasuan, disa organe mediatike publikuan pjesë të kufizuara të kësaj databaze. Ndërkohë, nisi qarkullimi me këtë aplikacion edhe i databazës që përmbante, ndër të tjera, pagat për *muajin prill 2021* për 910061 individë. Po ashtu, u përhap dhe publikua në të njëjtën mënyrë edhe databaza e tretë që përmbante, ndër të tjera, informacione për *targat/modelin e makinës/ngjyra* për 530452 individë.


Edhe për këto raste të rënda të cenimit të jetës private dhe të dhënave personale të qytetarëve, Zyra e Komisionerit nisi menjëherë punën në përmbushje të detyrave të saj mbikëqyrëse *ex-officio*. Pas administrimit në cilësinë e provës të këtyre databazave, u ndërmorrën veprimet administrative të nevojshëm për verifikimin e të gjitha shkeljeve eventuale nga kontrollues të ndryshëm. Duhet theksuar fakti, se për shkak të kompleksitetit të çështjes është ndërvepruar me një tërësi institucionesh, ndër to edhe ligjzbatuese, si dhe me kompaninë mëmë të aplikacionit “WhatsApp”. (Facebook), për marrjen e masave për të minimizuar risqet dhe ndalimin e përhapjes së paligjshme të të dhënave personale. Hetimet administrative të ndërmarra në lidhje me këto raste janë ende në proces.

III.2 Vendimmarrja


Në zbatim të detyrimeve ligjore, për qartësimin e rrethanave dhe fakteve në lidhje me proceset administrative të kryera, u zhvilluan në total 39 seanca dëgjimore. Në përfundim, Komisioneri doli me 42 Rekomandime, 1 Urdhër dhe me 12 Vendime, të cilat korrespondojnë me 31 sanksione administrative.



Sanksione administrative




Vlera e sanksioneve (në mijë lekë)



III.3 Regjistri i Njoftimeve

Në përmbushje të detyrimit ligjor të kontrolluesve për të njoftuar për përpunimin e të dhënave personale, gjatë këtij viti, në Regjistrin e Njoftimeve u shtuan 76 subjekte të reja. Gjithashtu, u regjistruan deklaratat e 30 kontrolluesve, për ndryshim të gjendjes së njoftimit të mëparshëm. Numri i përgjithshëm i kontrolluesve në Regjistrin e Njoftimeve, që e ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë, është 5818.



III.4 Transferimi ndërkombëtar

Niveli i mbrojtjes së të dhënave personale për një shtet përcaktohet duke vlerësuar të gjitha rrethanat lidhur me përpunimin, natyrën, qëllimin dhe kohëzgjatjen e tij, shtetin e origjinës dhe destinacionin përfundimtar, sipas kuadrit rregullator në fuqi (ligjit nr. 9887/2008, Vendimin nr. 8/2016, Udhëzimin 41/2014). Zyra e Komisionerit trajtoi 5 praktika për autorizimin e transferimit në disa shtete pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale dhe Komisioneri doli me 1 Vendim për lejimin e transferimit ndërkombëtar.

IV. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

IV.1 Hartimi i akteve rregullatore

IV.1.1 Përafrimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me GDPR dhe Direktivën e Policisë

Kuadri ligjor shqiptar përbëhet nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale i përafruar në mënyrë të plotë me Direktivën 95/46 EC dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Më 25 maj 2018, hyri në fuqi GDPR, e cila shfuqizoi këtë Direktivë. Synimi i GDPR është zgjerimi dhe përmirësimi i garancive për mbrojtjen e të dhënave personale, në një kohë kur nga zhvillimi teknologjik përpunimi i tyre është shumëfishuar. Kjo reformë rregullatore përfshin edhe modernizimin e proceseve përpunuese në kuadër të veprimtarisë dhe bashkëpunimit të organeve ligjzbatuese në fushën penale, nëpërmjet miratimit të Direktivës së Policisë dhe shfuqizimit të vendimit kuadër 2008/977/JHA.

Në këtë kontekst, domosdoshmëria e përafrimit të legjislacionit shqiptar me këto akte evropiane është plotësimi i kërkesave të parashikuara në dokumentet strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të integritetit të vendit në BE. Ky proces përafrues me *acquis communautaire* ka për qëllim t'u garantojë qytetarëve shqiptarë të njëjtat standarde të larta për mbrojtjen e të dhënave personale. Zyra e Komisionerit, me mbështetjen e ekspertëve të Projektit të Binjakëzimit hartoi projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe 13 akte nënligjore për zbatimin e tij në praktikë. Duke qenë se GDPR vjen si vazhdimësi e Direktivës 95/46 EC, rrjedhimisht, edhe projektligji i propozuar përmirëson dukshëm kuadrin rregullator të mbrojtjes së të dhënave në Shqipëri, në këto drejtime kryesore:

- zgjerohet gama e të drejtave të subjektit të të dhënave dhe në të njëjtën kohë, forcohen masat e garantimit të tyre, duke i dhënë qytetarit kontroll më të lartë mbi të dhënat personale;
- shtohen detyrime të tjera për kontrolluesit/përpunuesit, të cilat prezantohen për herë të parë në legjislacion, të cilat ndikojnë në efektivitetin e sigurisë së informacionit në procesin e përpunimit të të dhënave personale;
- forcohen kriteret për dhënien dhe vlefshmërinë e pëlqimit të subjektit të të dhënave, duke përfshirë trajtimin e aspekteve praktike për dhënien e pëlqimit nga fëmija, si dhe pëlqimin me mjete elektronike;
- parashikohen për herë të parë rregulla mbi përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet ligjzbatuese në sferën penale, të cilat konsiderohen si *lex specialis* për këtë fushë;
- rishikohen në rritje sanksionet administrative, si një tregues i qartë për rëndësinë që ka mbrojtja e të dhënave personale dhe zbatimi i detyrimeve që burojnë nga kuadri ligjor;

- *forcohet mandati i Komisionerit në interes të pavarësisë institucionale dhe zgjerohen kompetencat, përfshi, për herë të parë, edhe ato ndihmëse, hetimore dhe korrigjuese në funksion të përmbushjes së parashikimeve ligjore.*

IV.1.2 Hartimi i projektaktit për përmirësimin e ligjit për të drejtën e informimit

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 119/2014, garantimi i kësaj të drejte të qytetarëve ka njohur përmirësim të dukshëm, duke ndikuar në rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike. Problematikat e hasura gjatë zbatimit të tij, por edhe sugjerimet/propozimet e vazhdueshme të grupeve të interesit, kanë sjellë nevojën e përmirësimit të rregullave në këtë fushë. Gjithashtu, këto përmirësime do të ndikojnë në reduktimin e hapësirave për korrupsion dhe rritjen e besimit të publikut. Për këtë qëllim, Zyra e Komisionerit hartoi projektligjin *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014 “Për të drejtën e informimit”*”. Vlen të theksohet se ky projekt akt u avancua në këtë moment, si pasojë e ndryshimeve paralele ligjore në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.


Ndryshimet dhe shtesat e propozuara përmirësojnë dhe forcojnë rregullat dhe procedurat e legjislacionit aktual dhe konsistojnë në:

- *parashikimin e kompetencave të Komisionerit për fushën e të drejtës për informim në ligjin që rregullon këtë veprimtari;*
- *krijimin e Bordit Këshillimor, i cili do të shërbejë si një mekanizëm rekomandues mbi zbatimin sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirës të ligjit;*
- *përfshirjen në Programin e Transparencës të vendimmarrjes së organeve të prokurorisë për veprat penale që kanë interes të lartë publik, më qëllim rritjen e transparencës në sistemin e drejtësisë, sipas përcaktimeve të bëra në Programin model të Transparencës të miratuar nga Komisioneri për këtë kategori autoritetesh publike;*
- *mundësinë e sanksionimit të personit përgjegjës për refuzimin e dhënies së informacionit, përveç rasteve kur përgjegjës është koordinatori;*
- *përcaktimin e Vendimit të Komisionerit për dhënie të informacionit si titull ekzekutiv, me kalimin e afatit të përcaktuar në vendim;*
- *përfitimin e një shtesë page për natyrë të veçantë pune për koordinatorin për të drejtën e informimit.*

Të dy këto projekt akte janë depozituar në Ministrinë e Drejtësisë për të vijuar me procedurat deri në miratimin e tyre, në cilësinë e institucionit lider të Kapitullit 23 të negociatave për anëtarësimin në BE *“Gjyqësori dhe të drejtat themelore”*, ku Zyra e Komisionerit është pjesë.

IV.2 Dhënie mendimi për projektakte

Për vitin 2021, institucioni ka dhënë mendim për 22 projekt akte rregullatore (projektligje, projektvendime dhe projekt marrëveshje), si dhe janë përgatitur 69 opinione ligjore të paraqitura për mendim nga kontrollues publik e privat. Theksojmë, se ende ka një kulturë të ulët të institucioneve në zbatimin e detyrimit për të konsultuar projekt aktet që kanë në objektin e tyre edhe përpunimin e të dhënave personale, për të cilat Zyra e Komisionerit nuk është konsultuar paraprakisht.



IV.3 Proceset gjyqësore dhe ekzekutimi i vendimeve

Për këtë vit u ndoqën 34 procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, mbi zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, ku përmendim se për 13 çështje gjykata konfirmoi vendimarrjen e institucionit.

Çështje me objekt ligjin nr. 119/2014	2021
Procese Gjyqësore	34
Rrëzim padie	13
Pranim padie	2
Pushim gjykimi për Zyrën e Komisionerit	3
Pranim i pjesshëm i padisë	4
Mos kompetencë tokësore	3
Çështje e kthyer për mangësi në kërkesë padi	1
Çështje në proces	8

Ndërsa, po pranë kësaj gjykate u ndoqën 8 procese në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, prej të cilave për 2 çështje është konfirmuar vendimarrja e institucionit.

Çështje me objekt ligjin nr. 9887/2008	2021
Procese Gjyqësore	8
Rrëzimin e kërkesë padisë	2
Në proces	6

Zyra e Komisionerit është palë në 51 procese gjyqësore që shqyrtohen në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe gjatë vitit 2021, u trajtua vetëm 1 çështje për të cilën gjykata konfirmoi vendimarrjen e institucionit.

V. PROJEKTI I BINJAKËZIMIT

Privatësia dhe mbrojtja e të dhënave personale është një fushë dinamike dhe gjithnjë në zhvillim. Për vetë rëndësinë që mbart reforma rregullatore në BE dhe si një vend që është në procesin e negociatave për integrim, Zyra e Komisionerit intensifikoi hapat për përafrimin e legjislacionit kombëtar në fuqi nëpërmjet zbatimit të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje institucionit për përafrimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis-in* e Bashkimit Evropian”.

Ky Projekt Binjakëzimi ndërmjet Italisë, Austrisë dhe Shqipërisë, u financua nga Bashkimi Evropian në vlerën e 400.000 Euro, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit në BE, IPA 2017, për periudhën 1 tetor 2020 – 15 dhjetor 2021.



Ky Projekt u zbatua nga Autoriteti Italian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (*Autorità Garante per la Protezione dei Dati Personali*), Instituti “Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore Ludwig Boltzmann” në Austri, me mbështetjen e CSI-Piemonte në Itali. Krahas tyre, CFCU ka qenë një bashkëpunëtor dhe partner i ngushtë i Zyrës së Komisionerit në cilësinë e autoritetit kontraktues.



CFCU
CENTRAL FINANCE AND CONTRACTING UNIT



GPDP

GARANTE
PER LA PROTEZIONE
DEI DATI PERSONALI



LUDWIG
BOLTZMANN
INSTITUTE
Fundamental and Human Rights



your digital partner

Ky Projekt përbëhet nga 3 komponentë: a) Përafrimi i legjislacionit kombëtar me GDPR dhe Direktivën e Policisë; b) Ndërtimi i kapaciteteve për zbatimin e kuadrit të ri ligjor mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe c) Rritja e ndërgjegjësimit të kontrolluesit dhe përpunuesit në mënyrë që të sigurohet që ata të veprojnë në përputhje me ligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale. Pandemia Covid-19 ndikoi që aktivitetet të zhvilloheshin virtualisht, duke krijuar mundësinë e përfshirjes së një numri më të gjerë ekspertësh në raport me parashikimin fillestar. Më 16 shkurt 2021, Zyra e Komisionerit zhvilloi takimin e lançimit të tij, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve shqiptare dhe të huaja, të cilët vlerësuan përpjekjet e institucionit për jetësimin e kësaj iniciative dhe u angazhuan të mbështesin në vazhdimësi autoritetin në përmbushjen e detyrave të tij.



V.1 Zbatimi i Projektit të Binjakëzimit

Për realizimin e Projektit të Binjakëzimit u parashikuan një sërë masash për secilin prej komponentëve përbërës të tij.

Komponenti 1 “Përafrimi i legjislacionit kombëtar me GDPR dhe Direktivën e Policisë” u fokusua në:

- ✓ rishikimin dhe analizën krahasuese të ligjit shqiptar në fuqi me atë në BE;
- ✓ prezantimin e gjetjeve përpara grupeve të interesit dhe hartimin e rekomandimeve;
- ✓ hartimin e strategjisë për përafrimin e kuadrit ligjor shqiptar me atë evropian;
- ✓ ndryshimin e legjislacionit kombëtar në përputhje me GDPR dhe Direktivën e Policisë;
- ✓ hartimin e projekt akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri.

Komponenti 2 “Ndërtimi i kapaciteteve për zbatimin e kuadrit të ri ligjor mbi mbrojtjen e të dhënave personale” u fokusua në:

- ✓ trajnimin e stafit të Zyrës së Komisionerit për kuadrin rregullator të BE;
- ✓ rritjen e kapaciteteve administrative të institucionit për të menaxhuar legjislacionin e ri;
- ✓ ofrimin e njohurive të nevojshme dhe praktikave më të mira nga zbatimi i GDPR dhe Direktivës së Policisë në vendet anëtare të BE.

Komponenti 3 “Rritja e ndërgjegjësimit tek kontrolluesit dhe përpunuesit në mënyrë që të sigurohet që ata të veprojnë në përputhje me ligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale” u fokusua në zhvillimin e takimeve informuese/trajnuese me grupe interesi nga sfera publike dhe ajo private.



Rezultat i zbatimit të Komponentit 1 është hartimi i projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i përafuar plotësisht me GDPR dhe Direktivën e Policisë.

Drafti përfundimtar 08/05/2021 LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE PJESA I OBJEKTI DHE OBJEKTIVAT <i>Neni 1</i> Objekti Ky ligj përcakton rregullat për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave të tyre. <i>Neni 2</i> Objektivi Përpunimi i ligjshëm i të dhënave në lidhje me personat fizikë respekton dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të tyre, dhe veçanërisht të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, siç parashikohet në nenin 35 të Kushtetutës së Shqipërisë. PJESA II PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE PËRVËQË CHËSHTJEVE TË RREGULLUARA NË PJESËN III KAPITULLI I Dispozita të përgjithshme <i>Neni 3</i> Përkufizime 1. “të dhëna personale” (“të dhëna”) nënkupton çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekti i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është dikush që mund të identifikohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi si një emër, numër identifikimi, të dhënat e vendndodhjes, një identifikuesi në internet ose një ose më shumë faktorëve specifik për fizikun, fiziologjinë, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror të atij personi fizik;	Drafti përfundimtar 08/05/2021 a) zakonisht ose të paktën shpesh ndiqet si një aktivitet në dukje i drejtë, së bashku me qëllimin fillestar të përpunimit, në afërsi si në kohë, edhe në kuptim kontekstual, kështu që përpunimi shitesh për atë qëllim të ri duhet të pritet nga subjekti i të dhënave, dhe i cili b) nuk paraqet rreziqe të konsiderueshme shtesë për subjektin e të dhënave ose kur këto rreziqe janë zbutur me sukses nga masa mbrojtëse shtesë për të drejtat dhe interesat e subjektit të të dhënave, si rezultat i masave të marra nga kontrolluesi; 5. “profilizim” nënkupton çdo formë përpunimi të automatizuar të të dhënave personale që konsiston në përdorimin e të dhënave personale për të vlerësuar aspekte të caktuara personale që lidhen me një person fizik, në veçanti për të analizuar ose parashikuar aspekte në lidhje me performancën e atij personi fizik në punë, situatën ekonomike, shëndetin, preferencat personale, interesat, besueshmërinë, sjelljen, vendndodhjen ose lëvizjet; 6. “të dhëna të pseudonimizuara”, nënkupton të dhënat personale të cilat janë trajtuar në atë mënyrë që të dhënat personale nuk mund t’i atribuohen një subjekti specifik të të dhënave pa përdorimin e informacioneve shtesë, me kusht që ky informacion shtesë të ruhet veçmas dhe t’i nënshtrohet masave teknike dhe organizative për t’u siguruar që të dhënat personale nuk mund t’i atribuohen një personi fizik të identifikuar ose të identifikueshëm, përveç nëse autorizohet posaçërisht; 7. “të dhëna të anonimizuara” nënkupton të dhëna, të cilat kanë qenë fillimisht të dhëna personale, por janë trajtuar në atë mënyrë, sa nuk është më e mundur t’i atribuohen një personi të identifikuar ose të identifikueshëm; 8. “të dhëna sensitive” nënkupton kategoritë e të dhënave të renditura në Nenin 9, paragrafi 1; 9. “të dhëna gjenetike” nënkupton të dhënat personale në lidhje me karakteristikat gjenetike të trashëguara ose të fituara të një personi fizik, të cilat japin informacion unik në lidhje me fiziologjinë ose shëndetin e atij personi fizik dhe që rezultojnë, në veçanti, nga një analizë e një kampioni biologjik nga personi fizik në fjalë; 10. “të dhëna biometrike” nënkupton të dhëna personale që rezultojnë nga përpunimi teknik specifik në lidhje me karakteristikat fizike, fiziologjike ose të sjelljes të një personi fizik, të cilat lejojnë ose konfirmojnë identifikimin unik të atij personi fizik, siç janë imazhet e fytyrës ose gjurmët daktiloskopike; 11. “të dhëna penale” nënkupton të dhënat personale në lidhje me dënimet dhe veprat penale ose masat e sigurisë që lidhen me to; 12. “sistem arkivimi” nënkupton çdo grup të strukturuar të të dhënave personale, i cili është i aksesueshëm sipas kriterëve specifikë në lidhje me personat fizikë, qofshin të centralizuar, të decentralizuar ose të shpërndarë në një ose më shumë sisteme të dhënash;
---	---

Ndërsa, për sa i përket legjislacionit dytësor, u rishikuan dhe u hartuan 13 projekt akte, të cilat janë:

- ✓ Udhëzim për detyrimin për të kryer një vlerësim të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave;
- ✓ Udhëzim për përjashtimet nga detyrimi për të kryer një vlerësim të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave;
- ✓ Udhëzim mbi përpunimin, mbrojtjen dhe sigurinë e meta të dhënave të komunikimit elektronik në rrjetet publike të komunikimit elektronik;
- ✓ Udhëzim për përpunimin e të dhënave personale në regjistrat publik;
- ✓ Udhëzim për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e mbikëqyrjes me kamera;
- ✓ Udhëzim për përpunimin e të dhënave personale në fushën e arsimit;
- ✓ Udhëzim për masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e arsimit;
- ✓ Udhëzim mbi rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në mediane dhe shkruar, vizive dhe audiovizive;
- ✓ Udhëzim për specifikimin e afateve dhe kushteve të përjashtimit nga detyrimet përkatëse për përpunimin e të dhënave për qëllime gazetarie, letrare ose artistike;
- ✓ Udhëzim mbi përcaktimin e shteteve që sigurojnë nivelin e duhur për mbrojtjen e të dhënave personale;
- ✓ Udhëzim mbi transferimin e të dhënave në shtete që nuk kanë nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhënave personale;
- ✓ Udhëzim mbi mbrojtjen e të dhënave personale në marketingun e drejtpërdrejtë, përfshirë masat e duhura të sigurisë;
- ✓ Udhëzim për përcaktimin e periudhave të ruajtjes të të dhënave personale të përpunuara nga organet e policisë të shtetit për sigurinë publike apo kombëtare dhe për parandalim dhe ndjekje të çrregullimeve apo krimit.



Rezultat i zbatimit të Komponentit 2 ishte rritja e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit për njohjen integrale të legjislacionit të BE në këtë fushë. Për përmbushjen e kësaj mase të Projektit të Binjakëzimit u zhvilluan 5 module, që në terminologjinë ndërkombëtare njihen si *trajno trajnerët (train of the trainers)*. Në këto aktivitete, u trajtuan aspekte të rëndësishme të legjislacionit të ri për mbrojtjen e të dhënave, si përgjegjshmëria dhe llogaridhënia në procesin e përpunimit; vlerësimi i riskut për cenimin e privatësisë apo rolet e veçanta të përpunimit të të dhënave personale dhe ndarjen e përgjegjësisë brenda organizatës/institucionit. U diskutua edhe për çështje, si roli dhe funksionet e nëpunësit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave (data protection officer-DPO); qasja me konceptin e mbrojtjes së të dhënave në projektim (privacy by design) dhe mbrojtjes në mënyrë të paracaktuar (privacy by default); si dhe për rëndësinë e regjistrimit të aktiviteteve përpunuese. Po ashtu, vëmendje iu kushtua edhe risive rregullatore për të drejtën për t'u harruar (the right to be forgotten) dhe procesin e portabilitetit (transferueshmërinë) të të dhënave, të gjithë këta elemente shumë të rëndësishëm për sa i përket rritjes së ndërgjegjësimit të subjektit të të dhënave personale (qytetarit) për ushtrimin në praktikë të të drejtave të tij/saj.



Në kuadër të këtij Komponenti, u zhvilluan edhe 3 module të tjera trajnuese me qëllim njohjen e zbatimit në praktikë të GDPR dhe Direktivës së Policisë, si dhe shkëmbimin e eksperiencave më të mira ndërmjet partnerëve të Projektit. Tematikat e trajtuara përfshinë marrëdhëniet dhe përgjegjësitë e kontrolluesit apo kontrolluesve të përbashkët, marrëdhëniet kontrollues-përpunues; kompetencat e autoritetit mbikëqyrës, sidomos, për sa i përket procesit të hetimit dhe sanksioneve administrative. Kuadri rregullator evropian ka forcuar dhe zgjeruar kriteret në lidhje me aspektet e pëlqimit dhe interesit legjitim; transferimit ndërkombëtar apo detyrave të nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këto aktivitete u diskutua edhe për certifikimin dhe organet certifikuese; auditimin e kontrolluesve për përmbushjen e detyrimeve të tyre në lidhje me të dhënat personale; kodet e sjelljes, si dhe për marrjen në tërësi të masave tekniko-organizative për garantimin e një procesi të sigurt. U trajtuan edhe çështje që kanë lidhje me menaxhimin e marrëdhënieve me autoritetet homologe dhe organizmat evropiane e ndërkombëtare, si dhe atyre me publikun dhe median.



Në përmbyllje të aktiviteteve për këtë Komponent, u zhvillua vizita studimore 4-ditore virtuale me qëllim shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira rregullatore. Pjesa e parë u fokusua në historikun e krijimit, rolin dhe funksionimin e autoritetit homolog italian, kryesisht, në kompetencat për organizimin e hetimit administrativ dhe në detyrat e departamentit TIK. Po ashtu, u diskutuan edhe çështje që kanë të bëjnë me koncepte si privatësia/mbrojtja e të dhënave në media e rrjete sociale, në sektorin e telekomunikacionit, tregtimin e drejpërdrejtë dhe bullizmin kibernetik. Në gjysmën e dytë u trajtua eksperiencia austriake për zbatimin e legjislacionit të fushës, duke sjellë përvojën e veprimtarisë së ministrive të Drejtësisë dhe të Brendshme dhe të gjykatave Administrative Supreme dhe Federale të këtij vendi. Nëpërmjet rasteve praktike u trajtua jurisprudenca dhe vendimmarrja e institucioneve përkatëse, duke e vënë theksin tek rritja e përgjegjshmërisë në procesin e përpunimit të të dhënave personale.

Rezultat i zbatimit të Komponentit 3, ishte njohja dhe ndërgjegjësimi i kontrolluesve/përpunuesve publik e privat dhe grupeve të interesit mbi përmbajtjen e legjislacionit të ri të fushës. Për këtë qëllim u zhvilluan 11 aktivitete, me pjesëmarrjen e më shumë se 550 përfaqësuesve të subjekteve që e ushtrojnë veprimtarinë në sektorë e fusha të ndryshme, si më poshtë.

✓ *Webinar me institucione publike*

Në bashkëpunim me ASPA, u zhvillua 2 module trajnimi me pjesëmarrjen e mbi 80 përfaqësuesve të institucioneve të pushtetit qendror, të pavarura dhe të vetëqeverisjes vendore. Në fokus ishte rritja e përgjegjshmërisë së kontrolluesve publik për përmbushjen e detyrimeve ligjore.

✓ *Webinar me OSHC dhe median*

Në këtë trajnim morën pjesë mbi 30 përfaqësues të organizatave të ndryshme të shoqërisë civile dhe subjekteve mediatike, me fokus ndërgjegjësimin për zbatimin e të drejtave të qytetarëve. Këto grupe interesi luajnë rol të rëndësishëm në funksionimin e sistemit demokratik dhe forcimin e shtetit ligjor.

✓ *Webinar me sektorin shëndetësor*

Trajnimi u zhvillua me pjesëmarrjen e mbi 50 përfaqësuesve nga institucione publike dhe subjekte private që ushtrojnë veprimtarinë në këtë sektor. Si një nga më të mëdhenjtë në përpunimin e të dhënave personale (sensitive), në fokus të tij ishte respektimi i të drejtave të qytetarëve për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit në tërësi dhe sidomos, në aspektin teknologjik.

✓ *Webinar me institucionet ligjzbatuese*

Në këtë trajnim ishin pjesëmarrës mbi 60 zyrtarë nga Prokuroria, Policia e Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ku u prezantua përfshirja e Direktivës së Policisë në legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave personale. Kuadri i ri rregullator zgjeron dhe forcon garancitë për respektimin e të drejtave të qytetarëve nga organet kompetente për qëllimet e parandalimit, hetimit, zbulimit/ndjekjes të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave.

✓ *Webinar me sektorët bankar/financiar dhe telekomunikacionin*

Në këtë aktivitet morën pjesë mbi 60 përfaqësues nga institucione publike dhe subjekte private që e ushtrojnë veprimtarinë në sektorin bankar/financiar dhe në atë të telekomunikacionit. Vëmendje iu kushtua aspekteve që kanë të bëjnë me përmirësimet teknologjike në ofrimin e shërbimeve, pa cenuar sigurinë e përpunimit të të dhënave personale.



✓ *Webinar me institucione të arsimit të lartë*

Ky trajnim u zhvillua me pjesëmarrjen e më shumë se 130 përfaqësuesve të stafeve akademike e administrative dhe studentë të universiteve publike e private. Roli i tyre është formimi i profesionistëve të së ardhmes dhe si i tillë, njohja e kuadrit të ardhshëm rregullator është kontribut për një brez të ri të informuar dhe të përgatitur për sfidat e zhvillimit ekonomik e shoqëror.

✓ *Webinar me Shkollën e Magjistraturës dhe sistemin e drejtësisë*


Me pjesëmarrjen e mbi 25 përfaqësuesve të këtyre institucioneve, u prezantua legjislacioni i ri që përafrohet Direktivën e Policisë dhe u trajtuan shembuj nga praktika për garantimin e të drejtave të qytetarëve në sferën penale. Shkolla e Magjistraturës ka rol të veçantë e të rëndësishëm në formimin e profesionistëve të ardhshëm të kësaj fushe.

✓ *Webinar me përfaqësues të profesioneve të lira*

Trajnimi u zhvillua me pjesëmarrjen e mbi 30 avokatëve, noterëve dhe ndërmjetësve gjyqësorë. Në të u trajtuan aspekte të proceseve përpunuese dhe përmbyshjen e detyrimeve ligjore në raport me marrjen e këtyre shërbimeve nga qytetarët.

✓ *Webinar mbi sigurinë e të dhënave personale*

Në këtë aktivitet, pjesëmarrës ishin mbi 30 përfaqësues nga institucione të pavarura/shtetërore që ofrojnë shërbime në rrugë elektronike nëpërmjet sistemeve TIK, si dhe nga parti politike që përpunojnë të dhëna personale në kuadër të veprimtarisë së tyre. Në trajnim u diskutua për çështje që kanë të bëjnë me një proces të sigurt, përpunimin e të dhënave personale gjatë fushatave zgjedhore, konceptin e cenimit të tyre dhe marrjen e masave konkrete për t'i shmangur ato.



✓ *Webinar me nxënës të arsimit parauniversitar*

Ky aktivitet u mbajt për ndërgjegjësimin e nxënësve të arsimit 9-vjeçar për koncepte e njohuri për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale në mjedisin digjital e sidomos, në rrjetet sociale. Qëllimi i trajnimit ishte njohja me mjete e mënyra për parandalimin e fenomeneve negative si bullizmi online, vjedhja e identitetit apo kontaktet e padëshiruara. Aktiviteti u mbajt, njëkohësisht, me mbi 60 nxënës të shkollave 9-vjeçare “Servete Maçi” dhe “Kosova” në Tiranë.

Në zbatim po të Komponentit 3, u hartuan katër dokumente me funksion udhëzues në kuadër të legjislacionin e ri të fushës për:

- rolet e ndryshme dhe shpërndarjen e përgjegjësi në marrëdhëniet mes kontrolluesit dhe përpunuesit;
- detyrimet e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave;
- procesin e vlerësimit të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave;
- konceptin e pëlqimit.



Ceremonia e mbylljes së Projektit të Binjakëzimit u zhvillua më 12 dhjetor 2021, të cilën e nderuan me pjesëmarrjen e tyre zyrtarë të lartë shqiptarë dhe të huaj. Fryma e bashkëpunimit dhe sinergjia mes Zyrës së Komisionerit dhe partnerëve italianë e austriakë, ndikoi për arritjen e një produkti cilësor e të qëndrueshëm, si dhe përbën një rezultat konkret në funksion të procesit të integritetit të vendit në BE.



Të gjithë veprimtarinë e zhvilluar në kuadër të këtij Projekti e konsultoni në faqen e Zyrës së Komisionerit.

V.2 Ndikimi i Projektit të Binjakëzimit

Zbatimi i këtij Projekti Binjakëzimi ndikon në konsolidimin e kapaciteteve institucionale, përveçse ka rol të drejtpërdrejtë në procesin e integritetit evropian të vendit. Nga ana tjetër, ai ka

kontribuuar në rritjen e ndërgjegjësimit të kontrolluesve/përpunuesve për zbatimin e detyrimeve ligjore dhe rritjen e kulturës së qytetarëve në ushtrimin e të drejtave të tyre. Për qëndrueshmërinë e këtyre përfitimeve në kohë u realizuan elementë të vizibilitetit si seksioni i posaçëm i Projektit në faqen zyrtare (<https://www.idp.al/twinning/>) dhe materiale me karakter promovues si video dhe broshura.



VI. VEPRIMTARIA PËR BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR, STRATEGJITË NDËRSEKTORIALE, NDËRGJEGJËSIMIN DHE PROMOVIMIN

VI.1 Pjesëmarrja në forume dhe rrjete ndërkombëtare

VI.1.1 Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit

Në muajin maj 2021, u zhvilluan për herë të parë votimet për Komitetin Ekzekutiv të ICIC, ku Zyra e Komisionerit u përzgjedh si anëtare e forumit më të lartë drejtues të kësaj organizate. Ky proces ishte pjesë e zbatimit të planit të ristrukturimit të saj, i sanksionuar në Kartën e Johannesburg 2019. Zgjedhja në Komitetin Ekzekutiv është vlerësim për përpjekjet institucionale dhe të autoriteteve publike shqiptare për forcimin e transparencës dhe rritjen e llogaridhënies në zbatimin e detyrimeve të legjislacionit për të drejtën e informimit. Anëtarësimi në këtë forum ishte objektivi kryesor në marrëdhëniet ndërkombëtare të institucionit në periudhën afat-mesme. Funksionimi i forumit nisi pas zhvillimit të Konferencës së ICIC 2021(virtuale), të organizuar nga autoriteti brazilian. Kjo organizatë është themeluar në vitin 2003 dhe përbën platformën kryesore globale për të nxitur dhe promovuar të drejtën e informimit.

Në datat 23-24 qershor 2021, me tematikë qendrore *“E drejta e informimit për një botë në ndryshim, përdorimi i teknologjisë për të nxitur gjithëpërfshirjen”*, u zhvilluan punimet e Sesionit të Mbyllur të ICIC, edicioni i 12-të. Mbi 60 autoritete kombëtare/rajonale anëtare e vëzhguese u përfaqësuan në takimet e Konferencës, ku u diskutua për zhvillimet më të fundit të fushës dhe u miratuan këto dokumente:

- ✓ Strategjia 2021-2024;
- ✓ Manuali i procedurës për organizimin dhe funksionimin e ICIC, Komitetit Ekzekutiv dhe Grupeve të punës;
- ✓ Përcaktimi i Komitetit Ekzekutiv për rishikimin e Kartës së Johannesburgut 2019;
- ✓ Rezoluta “Dhënia në mënyrë proaktive e informacionit në lidhje me Covid-19”.

Të gjitha aktivitetet e tjera në kuadër të Konferencës me anëtarësinë apo grupet e interesit u mbajtën përgjatë pjesës së mbetur të vitit, me tematika si *“kufizimet e mjegullta të aksesit në informacion”*, *“ndërveprimi mes aksesit në informacion dhe ofrimi i shërbimeve publike”*, *“ndërveprimi midis mbrojtjes së të dhënave dhe aksesit në informacion”*, *“sfidat e transparencës në qeveritë digjitale: transparenca e administratës publike në përdorimin e inteligjencës artificiale”*. Gjatë kësaj periudhe, Zyra e Komisionerit ka marrë pjesë edhe në mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv, ku janë trajtuar çështje të ndryshme të funksionimit të ICIC.

VI.1.2 Asambleja Globale e Privatësisë

Në datat 18-21 tetor 2021 u zhvilluan punimet e edicionit të 43-të të GPA, në një format hibrid - online dhe fizikisht, të organizuara nga autoriteti meksikan. Në Sesionin e Mbyllur morën pjesë përfaqësues nga 153 autoritete anëtare/vëzhguese, ku u miratuan 5 dokumente, ku për 2 prej tyre Zyra e Komisionerit ka dhënë kontributin e saj:

- ✓ Rezoluta për të ardhmen e GPA dhe të Sekretariatit (Zyra e Komisionerit është bashkë-propozuese);
- ✓ Rezoluta për planin strategjik 2021-23 (Zyra e Komisionerit është bashkë-propozuese);
- ✓ Rezoluta për shkëmbimin e të dhënave për të mirën publike;
- ✓ Rezoluta për aksesin e qeverisë në të dhënat, privatësinë dhe sundimin e ligjit: Parimet për qasjen e qeverisë në të dhënat personale të mbajtura nga sektori privat për sigurinë kombëtare dhe atë publike;
- ✓ Rezoluta për të drejtat digjitale të fëmijëve.

Në punimet e këtij Sesioni u diskutua për çështje si *“qarkullimi i të dhënave dhe inovacioni”*, *“mësimet e nxjerra nga pandemia Covid-19”*, *“nxitja e inovacionit përmes angazhimit”* dhe *“bashkëpunimi ndërkombëtar për zbatimin e ligjit dhe shkëmbimi i eksperiencës”*. Në këtë të fundit, u përfaqësua edhe Zyra e Komisionerit, përkrah përfaqësuesve të autoriteteve homologe nga Britania e Madhe, Australia, Japonia, Kolumbia, Hong Kongu dhe Gana. Në të u soll përvoja e bashkëpunimit me autoritetin italian në zhvillimin e hetimeve të përbashkëta, me fokus zbatimin efektiv të të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale. Panelistët vlerësuan eksperiencën e prezantuar dhe theksuan se bashkëpunimi dy ose shumëpalësh në zbatimin e ligjit është rruga për adresimin e problematikave që sjell zhvillimi ekonomik, veçanërisht, përparimi teknologjik.

Në Sesionin e Mbyllur u paraqitën e miratuan raportet vjetore të Grupeve të Punës të GPA dhe u prezantua veprimtaria e disa organizmave partnere. Zyra e Komisionerit mori pjesë në mbledhjet e Komitetit Ekzekutiv, duke dhënë kontribut konkret për përgatitjen e dokumenteve dhe trajtimin e çështjeve për funksionimin e GPA.

Në kuadër të pjesëmarrjes në aktivitete të tjera me rëndësi për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, institucioni është angazhuar aktivisht edhe në takime/trajnime/webinar-e të organizuara nga:

- Komiteti Konsultativ i Konventës 108 të Këshillit të Evropës (T-PD);
- Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave;
- Konferenca Evropiane e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale;
- Rastet e Veçanta të Punës (Case Handling Workshop) të Konferencës Evropiane;
- Grupi Ndërkombëtar i Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Teknologji (Grupi i Berlinit);
- Rrjeti i Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEEDPA), ku Zyra e Komisionerit u përfaqësua në dy panele;

- Shoqata Frankofone e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave (AFAPDP);
- Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD), për Rekomandimin “Mbrojtja e fëmijëve në mjedisin digjital”;
- Projekti DECOS për “Zhvillimin e kapaciteteve, bashkëpunimit dhe kulturës së mbikëqyrjes së sektorëve të sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut”
- Këshilli Rajonal i Bashkëpunimit (RCC) për “Qarkullimin e lirë të të dhënave në Ballkanin Perëndimor”.

VI.2 Bashkëpunime dypalëshe

VI.2.1 Bashkëpunimi me autoritetin homolog të Kosovës

Një delegacion i Zyrës së Komisionerit zhvilloi një vizitë pune në Prishtinë, me ftesë të Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP). Palët ranë dakord të hartohet një marrëveshje për forcimin afatgjatë të bashkëpunimit, të shtohen kontaktet mes stafeve për shkëmbimin e eksperiencës, si dhe të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për mbështetjen e autoritetit të Kosovës në anëtarësimin/pjesëmarrjen në organizatat rajonale/ndërkombëtare në të dy fushat. Pjesë të kësaj vizite ishin edhe takimet me Avokatin e Popullit dhe me Nënkryetaren e Kuvendit të Kosovës.

VI.2.2 Bashkëpunimi me ambasadën britanike

Zyra e Komisionerit ka nisur në bashkëpunim me Ambasadën Britanike zbatimin e projektit “Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies të qeverive të Ballkanit Perëndimor nëpërmjet zhvillimit të komunikimeve efektive strategjike-Improving the openness and accountability of the governments of the Western Balkans through the development of effective strategic communications”. Projekti ka si qëllim administrimin më efikas të komunikimeve strategjike të autoriteteve publike, sidomos, në forcimin e rolit dhe kapaciteteve të koordinatorit dhe konsiston në hartimin e një manuali për veprimtarinë e tij, zhvillimin e aktiviteteve me grupet e interesit dhe përgatitjen e materialeve ndërgjegjësuëse (poster, broshura, video). Ky është një projekt 3-vjeçar dhe zbatohet nga *Shërbimi i Komunikimeve të Qeverisë-Government Communications Service* të kabinetit të Mbretërisë së Bashkuar.

VI.3 Strategji Ndërsektoriale

VI.3.1 Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015-2022 dhe Plani i ri i aktiviteteve 2018-2022

Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e Objektivit 11 “*Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion*”. Me qëllim përmbushjen e këtij objekti gjatë periudhës raportuese u realizuan 9 nënmasat e parashikuara në Planin vjetor të Veprimit.

VI.3.2 Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit 2020-2023

Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e objektivit A.1 “*Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion*”. Me qëllim përmbushjen e këtij objekti u realizuan të 3 masat e parashikuara në Planin vjetor të Veprimit.

VI.3.3 Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023 dhe Plan i Veprimit 2019–2023

Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për realizimin e objektivit IV “*Ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës*”. Me qëllim përmbushjen e këtij objekti u realizuan plotësisht 5 aktivitetet e parashikuara në Planin e Veprimit.

VI.3.4 Kontrata e Suportit Buxhetor për Mirëqeverisjen 2020

Zyra e Komisionerit është institucioni përgjegjës për zbatimin e indikatorit nr. 7 të Kontratës së Suportit Buxhetor për Mirëqeverisjen IPA 2020 “*Transparenca e aktivitetit shtetëror dhe aksesit në informacion për qytetarët*”. Sipas kontratës, target për vitin 2021 ishte “*Të paktën 35 institucione të tjera të kenë instaluar regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve krahasuar me vitin 2020*”. Ky indikator është përmbushur, pasi në fund të vitit 2021 numri i autoriteteve publike që kanë instaluar REKPD është 36 më shumë krahasuar me vitin 2020.

VI.3.5 Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plan i Veprimit 2018-2021

Zyra e Komisionerit është e përfshirë në objektivin 5.1.1 “*Ngritja dhe funksionimi i rrjetit ndërinstitutional në nivel qendror për çështjet e drejtësisë për të mitur*”, duke realizuar aktivitete ndërgjegjëse për çështje që lidhen me të miturit.

VI.4 Bashkëpunimi me shoqërinë civile

Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar me Organizata jo Fitimprurëse, ku në fokus ka qënë forcimi i zbatimit të të drejtës për informim. Me Institutin për Drejtësi dhe Ndërmjetësim (IDM) u trajnuan disa organizata lokale të shoqërisë civile për të monitoruar Programet e Transparencës të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Institucioni ka dhënë një kontribut aktiv në takime konsultative apo për raporte të OSHC të ndryshme, në kuadër të veprimtarisë së tyre monitoruese për autoritetet publike, si:

- *Raporti mbi kontrollin demokratik të Forcave të Armatosura, hartuar nga IDM;*
- *Raporti i monitorimit “Transparenca dhe Llogaridhënia në nivelin e qeverisjes vendore”, hartuar nga IDM;*
- *Sondazhi i Opinioneve Publik “Besimi në Qeverisje 2020”, zhvilluar nga IDM;*
- *Raporti i Monitorimit të Reformës në Administratën Publike 2019-2020 për Shqipërinë, hartuar nga IDM;*

- Raporti i vlerësimit të informimit dhe konsultimit publik nga institucionet qendrore të Qeverisë, hartuar nga Instituti Shqiptar për Zhvillim Politikash;
- Raporti Studimor “Përfshirja dhe angazhimi qytetar në nivel vendor”, hartuar nga Rrjeti i OSHC Përballja e Ofertave Politike;
- Raporti mbi të drejtën e informimit, hartuar nga BIRN;
- Raporti “Buxheti i Shtetit për Shëndetësinë dhe pandemia Covid-19”, hartuar nga “Together for Life”;
- diskutime me përfaqësues të Institutit Demokratik Kombëtar për forcimin e transparencës në parlament dhe pjesëmarrjen qytetare.

Në kuadër të projektit “Edukimi ligjor i studentëve rom, mediatorëve komunitar dhe të shëndetit për të lehtësuar aksesin në drejtësi për komunitetin e tyre”, Zyra e Komisionerit bashkëpunoi me organizatën Roma Versitas Albania. Për këtë qëllim u nënshkrua një marrëveshje dhe u zhvilluan trajnime me përfaqësues të komuniteteve rom dhe egjiptian. Ata u njohën me të drejtat kushtetuese të aksesit në informacionin publik dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale dhe me legjislacionin e zbatueshëm respektiv.

VI.5 Aktivitete të Zyrës së Komisionerit

Zyra e Komisionerit ka zhvilluar aktivitete me karakter trajnues e ndërgjegjësores në të dy fushat e veprimtarisë së saj, me fokus nxitjen e integritetit dhe përgjegjshmërisë për garantimin e të drejtave të qytetarëve.

- ✓ 28 Janari 2021, Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, përkoi me një moment historik për komunitetin e profesionistëve të privatësisë, me 40-vjetorin e Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” të Këshillit të Evropës, e njohur gjerësisht si Konventa 108. Në maj të vitit 2018 miratohet modernizimi i saj, duke e emërtuar atë Konventa 108+. Për të shënuar këtë përvjetor u përgatit videoja ndërgjegjësores, e publikuar në faqen e institucionit dhe në kanalin zyrtar në YouTube. Njëkohësisht, edhe KiE përgatiti e publikoi një videomesazh kremtues për këtë ngjarje, ku pjesë e iniciativës është edhe Komisioneri. Së fundi, në kuadër të 28 Janarit u mbajt aktiviteti në shkollën “Servete Maçi” në Tiranë. Takimi ishte pjesë e Fushatës Kombëtare “Edukimi digjital, luaj dhe mëso-Happy onlife”. Për Zyrën e Komisionerit zhvillimi i të tilla iniciativave ka rol të rëndësishëm, sepse shkolla bashkon mësuesin, fëmijën dhe prindin, për të ardhmen e një brezi të ri të shëndetshëm emocionalisht, kulturalisht dhe profesionalisht.
- ✓ Aktiviteti me rastin e 28 Shtatorit-Ditës së të Drejtës për Informim iu kushtua autoriteteve publike të sektorit shëndetësor. Zyra e Komisionerit vijon të bashkëpunojë e t’i asistojë këto institucione për përmbushjen e detyrimeve ligjore, duke qenë se ato kanë hasur në vështirësi objektive në këtë drejtim për shkak të pandemisë Covid-19. Çështjet kryesore të diskutuara ishin plotësimi dhe përditësimi i rubrikave të Programit të Transparencës apo rritja e cilësisë së informacionit për publikun nëpërmjet kthimit në afat të përgjigjeve për kërkesat nga qytetarët dhe grupet e interesit. Ky takim vijoi në muajin nëntor me një trajnim të

koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe personave të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në të u trajtua zbatimi i kuadrit rregullator në vlerësim të balancuar mes dy të drejtave, si dhe për problematikat e hasura në raport me përballimin e situatës së pandemisë.

- ✓ U zhvilluan 2 takime të veçanta për përmirësimin e transparencës proaktive dhe rritjes së llogaridhënies së autoriteteve publike me pjesëmarrjen e Sekretarëve të Përgjithshëm të ministrive, Kryetarë të Bashkive apo zyrtarë të lartë të tyre dhe me koordinatorët e të drejtës për informim. Në to u trajtuan problematika për funksionalizimin e plotë të Programeve të Transparencës, sipas modeleve respektive dhe përditësimi i Regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Po ashtu, u kërkuua përmirësimi i procesit të kthimit të përgjigjeve për kërkesat për informacion në afat dhe në përmbajtje, si dhe forcimi i rolit të koordinatorit në strukturën institucionale.
- ✓ Në bashkëpunim me ASPA, u zhvillua cikli prej 9 trajnimesh online me temë *“Balanca midis të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtës për informim”*. Pjesë e takimeve ishin më shumë se 180 nëpunës civilë të kategorive të ndryshme, me fokus pjesëmarrjen e koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe personat e ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave personale nga autoritete publike qendrore e të varësisë, të pavarura dhe NjVV. Trajnimet u zhvilluan duke marrë shkas nga raste praktike dhe vështirësitë që shfaqnin autoritetet publike në trajtimin në balancë të këtyre dy të drejtave.
- ✓ Institucioni zhvilloi 10 takime me koordinatorë dhe përfaqësues të autoriteteve publike qendrore e të varësisë dhe të pavarura, për t’i asistuar në publikimin e Programit të Transparencës dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, sipas modeleve të miratuara me Urdhërat nr. 187 dhe nr. 188/2020. Kanë vijuar takimet/trajnimet për funksionimin e REKPDI nga 36 autoritete publike që e kanë instaluar atë përgjatë vitit. Në bashkëpunim me AKSHI u zhvilluan trajnime me personat përgjegjës të 61 institucioneve për njohjen dhe përdorimin e sistemit të ri AMS.
- ✓ Një trajnim i dedikuar u zhvillua me prokurorët e medias dhe koordinatorët e të drejtës për informimit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore e të apelit. Në fokus ishte, veçanërisht, përditësimi/plotësimi i rubrikave të Programit të Transparencës, si një instrument i rëndësishëm në informimin e publikut, por dhe roli i koordinatorit në procesin e trajtimit të kërkesave të qytetarëve. Në aktivitet u trajtuan raste praktike të veprimtarisë së prokurorisë apo institucioneve ligjzbatuese dhe u diskutua për kufizimet e të drejtës për informim.
- ✓ Institucioni ishte pjesë e një trajnimi për punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), aktivitet i organizuar në bashkëpunim dhe koordinim nga Zyra në Shqipëri e Programit të Asistencës Ndërkombëtare për Trajnimin në Hetimin Penal (ICITAP) me Prezencën e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Pjesëmarrësit u njohën me legjislacionin e zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale, rolin dhe funksionet mbikëqyrës të Zyrës së Komisionerit, si dhe për raste nga praktika ku ndërthuret kuadri rregullator i fushës me atë që normon objektin e veprimtarisë së BKH.

- ✓ Në bashkëpunim me Qendrën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) u organizuan 2 trajnime me tematikë “*E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale në raport me çështjet e P/CVE-standardi bazë ligjor dhe rastet e kufizimeve të tyre*”. Në to morën pjesë stafi i qendrës dhe përfaqësues të institucioneve zbatuese të Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Në aktivitete u trajtua legjislacioni i të dy fushave të veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit në raport me objektin e punës së CVE.
- ✓ Vëmendje i është kushtuar edhe bashkëpunimit me IAL apo shoqatave studentore, në mënyrë që aktiviteti ndërgjegjësues i Zyrës së Komisionerit të prekë sa më shumë pjesë të shoqërisë.
 - U zhvillua takimi me përfaqësues të organizatës për “*Arsimin e lartë, sfidat për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit*”, ku u propozua miratimi i një Programi Transparence të dedikuar për këtë sektor.
 - U zhvilluan 3 aktivitete trajnuese me Universitetet “Aleksandër Moisiu” të Durrësit, “Fan Noli” të Korçës dhe “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, për njohjen e legjislacionit për të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale, me pjesëmarrjen e më shumë se 100 studentëve dhe stafit akademik/administrativ.
 - U zhvillua takimi me anëtarë të Klubit Studentor nga Fakulteti i Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, për njohjen e rolit dhe veprimtarisë së institucionit për forcimin e transparencës proaktive dhe rritjen e përgjegjshmërisë në përpunimin e të dhënave personale.
- ✓ U zhvillua takimi me një grup nxënësish të gjimnazeve të Tiranës, në kuadër të projektit “*Act on Hate*” (Vepra kundër urrejtjes) që zbatohet nga Qendra “*Act for Society*” (Vepra për shoqërinë). Të rinjtë shfaqën interes për veprimtarinë e institucionit dhe ata u njohën me, rolin e tij, legjislacionin e zbatueshëm dhe me një panoramë të aktiviteteve ndërgjegjësuese të zhvilluara ndër vite, në të gjithë vendin, kryesisht, me nxënës e mësues të arsimit parauniversitar.
- ✓ Zyra e Komisionerit përmbylli Fushatën Kombëtare “Edukimi digjital, luaj dhe mëso-Happy onlife”. U zhvilluan 32 aktivitete ndërgjegjësuese në shkolla 9-vjeçare në qytetet e Tiranës, Fierit, Beratit, Korçës, Vlorës, Gjirokastrës, Divjakës, Lushnjës, Kuçovës, Dimalit, Poliçanit, Patosit, Ballshit, Maliqit, Bilishtit, Ersekës, Pukës, Fushë-Arrëzit, Prrenjasit, Pogradecit, Memaliajt, Tepelenës, Përmetit, Orikumit, Himarës, Sarandës, Delvinës, Roskovecit dhe Selenicës me pjesëmarrjen e më shumë se 650 nxënës e mësues. Nëpërmjet lojës synohet aftësimi i grup moshës 12-15 vjeç për sjelljet që duhet të përshtatin, sidomos, në rrjetet sociale. Në këtë mënyrë, nxitet i menduari kritik për përdorimin e sigurt të të dhënave personale dhe aftësohen në parandalimin apo minimizimin e fenomeneve negative si bullizmi, përdorimi i identitetit të tjerëve, si dhe kontaktet e padëshiruara.
- ✓ U publikua Revista “Informim Dhe Privatësi”, numrat 11 dhe 12, përmbledhje të veprimtarisë institucionale, respektivisht, për 6-mujorin I dhe II të vitit 2021.
- ✓ U publikuan 12 Newsletters “*E drejta për informim*”, përmbledhje njohëse mujore mbi veprimtarinë, mbikëqyrjen për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit.

VII. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCAVE

VII.1 Menaxhimi i burimeve njerëzore

VII.1.1 Struktura organizative

Zyra e Komisionerit ka në strukturën e saj 44 punonjës, në përputhje me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 84/2020, efektet financiare të të cilit filluan në 1 janar 2021. Për zbatimin e tij, u ndërmorën të gjithë hapat proceduralë në ristrukturimin e njësive përbërëse të institucionit, pozicioneve të punës dhe niveleve/kategorive të pagave, konform legjislacionit në fuqi.

Kjo veprimtari është zhvilluar në dy etapa, fillimisht për ripozicionimin e stafit sipas strukturës së re dhe në vijimësi, për plotësimin e vendeve vakante. Menaxhimi i drejtë dhe racional i burimeve njerëzore, nënkupton zbatimin e drejtë të politikës për përparimin në karrierë, si dhe në rekrutimin e nëpunësve me kualifikimet e duhura, për kryerjen me cilësi e kompetencë të detyrave. Në këtë kontekst, Zyra e Komisionerit, konstaton me shqetësim, se për shkak të natyrës së veçantë të objektit të veprimtarisë institucionale, has shpesh në vështirësi për plotësimin e vendeve vakante, çka ka rezultuar në përsëritjen e procedurave për to. Për ecurinë e këtij procesi dhe problematikën e hasura është raportuar në Kuvend dhe te Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Në përfundim të vitit 2021, struktura u plotësua në nivelin 86% (38 pozicione pune), një procedurë rekrutimi u mbart dhe 5 pozicionet e mbetura vakante plotësohen gjatë vitit 2022.

Nga ana tjetër, ashtu sikurse Zyra e Komisionerit ka kërkuar nëpërmjet Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 – 2024, vlen të theksohet, se mbetet domosdoshmëri kompletimi i strukturës së institucionit, e veçanërisht asaj të mbrojtjes së të dhënave personale, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe kompetencave shtesë që burojnë nga legjislacioni i ri për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kjo është bërë prezent në mënyrë të vazhdueshme në Progres Raportet e Komisionit Evropian ndër vite, e veçanërisht në atë të vitit 2021, ku citohet:

“Nevojitet staf/personel shtesë në Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për përmbushjen e detyrave të shtuara të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale i cili pritet të miratohet së shpejti”.

VII.1.2 Zhvillimi i burimeve njerëzore

Zhvillimi profesional i burimeve njerëzore është një nga faktorët e rëndësishëm për përmbushjen e detyrimeve dhe objektivave institucionale. Drejtimet kryesore për sa i përket këtij elementi kanë konsistuar në:

- *zbatimin e praktikave rregullatore me transparencë e përgjegjshmëri në administrimin e procesit;*
- *rekrutimin e nëpunësve me rezultate të larta në arsimim;*
- *përmirësimin e kapaciteteve nëpërmjet kryerjes së vazhdueshme të trajnimeve;*
- *zbatimin e një sistemi objektiv të vlerësimit të stafit, bazuar në performancën e përmbushjes së detyrave funksionale dhe individuale.*

Duke marrë në konsideratë ndryshimet organizative, Programin vjetor të Punës dhe situatën vijuese me pandeminë Covid-19, në bashkëpunim me ASPA u realizua analiza e nevojave dhe u hartua kalendari i trajnimeve. 15 tematika u trajtuan në to, ndër më kryesoret kanë të bëjnë me procesin e integritetit dhe projektet e BE, menaxhimin e riskut, konfliktin e interesit, thellimin e njohjes së legjislacionit mbi shërbimin civil dhe atë financiar, mbi diskriminimin, qeverisjen elektronike dhe sigurinë kompjuterike, etj. Në 28 trajnime të zhvilluara morën pjesë 17 nëpunës të institucionit.

Procedurat për vlerësimin e rezultateve në punë të personelit janë përmbushur në kohë sipas standardeve të parashikuara në kuadrin ligjor të fushës. Një tregues mjaft i rëndësishëm i zbatimit të politikave të zhvillimit të burimeve njerëzore është edhe përfaqësimi gjinor, ku ky raport për vitin 2021 është 68% femra dhe 32% meshkuj. Vlen të theksohet fakti, se 6 nga 9 pozicionet e punës për nivelin e mesëm dhe të lartë drejtues mbahen nga gra.

VII.2 Menaxhimi i buxhetit

VII.2.1 Të ardhurat dhe shpenzimet

Në zbatim të ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2021” fondet e akorduara për Zyrën e Komisionerit, në total u miratuan në vlerën 78.200 (në mijë lekë).

Me ndryshimet gjatë vitit, buxheti u reduktua në 66.700 (në mijë lekë), me pakësimin e 11.500 (në mijë lekë) në zërin “shpenzime të personelit dhe të lidhura me to” dhe “shpenzime operative”, për shkak të procesit të ristrukturimit/plotësimit të vendeve vakante; rezervave të krijuara nga efektet pozitive të procedurave të prokurimit; kufizimit të aktiviteteve brenda/jashtë vendit.

Realizimi faktik i buxhetit është në vlerën 64.058 (në mijë lekë) ose në nivelin 96%.

REALIZIMI I TREGUESVE TË BUXHETIT

Nr.	EMËRTIMI	000/lekë		000/lekë	
		PLAN	% KUNDREJT TOTALIT	FAKT 12 MUJOR	% E REALIZIMIT KUNDREJT PLANIT VJETOR
1	Paga	42.726	64%	42.142	98.6%
2	Sigurime shoqërore	7.300	11%	6.987	95.7%
3	Mallra e shërbime të tjera	15.074	22.6%	13.491	89%
4	Investime	1.000	1.5 %	995	99.5%
5	Transferta dhe fondi i veçantë	500	0.8%	369	74%
6	Kuotizacione	100	0.1%	74	74%
	Totali	66.700	100%	64.058	96%

Ndër treguesit kryesorë të shpenzimeve, pjesën qendrore e përbëjnë pagat, realizuar në vlerën 42.142 (në mijë lekë) ose 98.6% dhe kontributet për sigurimet shoqërore/shëndetësore, realizuar në shifrën 6.987 (në mijë lekë) ose 95.7%. Shpenzimet korrente dhe investimet u realizuan në vlerën 14.929 (në mijë lekë) ose 89%. Mosrealizimet kanë ardhur si rezultat i ofertave më të ulta nga procedurat e prokurimeve dhe nga përdorimi në masën 40% i fondit të veçantë.

VII.2.2 Të ardhurat nga sanksionet

Në fund të vitit 2021, u arkëtuan në total të ardhura nga sanksionet administrative për shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi në vlerën 2.337.819 lekë, të cilat u arkëtuan 100% në buxhetin e shtetit. Sanksionet e vendosura vetëm për vitin 2021 janë në vlerën 4.730 (në mijë lekë), nga ku vlera e arkëtuar është 1.820 (në mijë lekë). Nga ana tjetër, është arkëtuar edhe shuma 517.819 lekë për sanksione administrative që i përkasin periudhave të mëparshme (2015-2020). Për vitin 2021, vërehet se 86% e vlerës së arkëtuar është shlyer vullnetarisht, tregues ky i ndërgjegjësimit për zbatimin në mënyrë të menjëhershme të vendimeve të Komisionerit.

VIII. PËRMBUSHJA E REKOMANDIMEVE TË RAPORTIT TË KOMISIONIT EVROPIAN PËR SHQIPËRINË

Në Raport Progresin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020 u adresuan rekomandimet e mëposhtme, për të cilat Zyra e Komisionerit duhet të angazhohej me kontribut të drejtpërdrejtë dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të përfshira në realizimin e tyre.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duhet të ketë kompetenca më të mëdha mbikëqyrjeje. Ekziston një regjistër qëdror për kërkesat për informacion, por mbulimi i tij duhet të zgjerohet.

Lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave 2016/679 dhe Direktivën e Policisë 2016/680.

Shqipëria nuk ka nënshkruar ende Protokollin 2018, i cili ndryshon Konventën për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale.

Kapaciteti i Zyrës së Komisionerit duhet të forcohet më tej, në mënyrë që ajo të kryejë detyrat e saj në mënyrë efektive.

Akresi në informacion në lidhje me kontratat e prokurimit, kontrollet dhe pagat e zyrtarëve, gjithashtu, duhet të forcohet. Vendimet e Komisionerit nuk janë detyruese për zyrtarët e administratës publike.

Në koordinim me Ministrinë e Drejtësisë, në cilësinë e institucionit lider të Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, është përgatitur Plani i Masave mbi zbatimin dhe monitorimin e përmbushjes së këtyre rekomandimeve, të cilat janë adresuar plotësisht nga ana e Zyrës së Komisionerit. Informacioni mbi veprimtarinë e institucionit dhe masat e marra në funksion të përmbushjes së këtyre rekomandimeve janë pjesë e tekstit të këtij Raporti, sipas kapitujve përkatës.



IX. PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE DHE RAPORTIME

Zyra e Komisionerit është pjesë e Kapitullit “Kriteri Politik”, Kapitullit 10 “Shoqëria e informacionit dhe media” dhe Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” të procesit të integritetit evropian. Si pjesë e detyrimeve që burojnë nga ky angazhim, por jo vetëm, është dhënë kontributi në:

- *Përgatitjen e informacionit mbi veprimtarinë e institucionit në kuadër të hartimit dhe dërgimit të kontributit të I, II, III dhe IV të qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021, për të tre Kapitujt.*
- *Përgatitjen e informacionit mbi veprimtarinë e institucionit në kuadër të zhvillimit të mbledhjes së Nënkomitetit të 13-të të Bashkimit Evropian “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, si dhe pyetjet shtesë.*
- *Përgatitjen e informacionit mbi veprimtarinë e institucionit në kuadër të zhvillimit të mbledhjes së Nënkomitetit të Administratës Publike (PAR-Special Group) me Komisionin Evropian, si dhe pyetjet shtesë.*
- *Hartimin e Planit Kombëtar për Integritetin Evropian 2022-2024 për Kapitullin 23.*
- *Hartimin e raporteve periodike në kuadër të planit të masave për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2020, ku përfshihet Zyra e Komisionerit.*
- *Hartimin e 4 raporteve periodike mbi detyrat e lëna në kuadër të Rezolutës së Kuvendit.*
- *Hartimin e 4 raporteve periodike mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Zyrës së Komisionerit për institucionet publike, si dhe përditësimi në kohë reale i “Platformës Ndërinstitucionale”.*
- *Ndjekjen e procesit të vlerësimit të SIGMA për Shqipërinë 2021 për Zyrën e Komisionerit dhe kontributit përkatës në sistemin PAR.IS.*
- *Përgatitjen e informacionit mbi zbatimin e indikatorit përkatës të Zyrës së Komisionerit në Kontratën e Suportit Buxhetor për Mirëqeverisjen 2020.*
- *Përgatitjen e informacionit mbi veprimtarinë e institucionit në kuadër të zhvillimit të takimit IPA-Sector Monitoring Committee për Demokracinë dhe Mirëqeverisjen/IPMG GG.*
- *Hartimin e 2 raporteve mbi zbatimin e Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut dhe Planit të Veprimit.*
- *Hartimin e 2 raporteve mbi zbatimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur dhe Planit të Veprimit.*

X. NIVELI I ZBATIMIT TË REZOLUTËS SË KUVENDIT 2021

Në Rezolutën e miratuar në datë 03.06.2021, Kuvendi kërkoi nga Zyra e Komisionerit përmbushjen e rekomandimeve të mëposhtme:

- Të vijojë të mbështesë dhe monitorojë autoritetet publike për vënien në zbatim të Programit të Transparencës të rishikuar dhe Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve.
- Të gjejë mekanizmat për të ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit të koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe nëpunësve të administratës shtetërore për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe përdorimin e regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve.
- Të ndërmarrë hapa institucionale dhe ligjore me autoritetet përkatëse për adresimin e plotë të kërkesave të pikës 1 të nenit 14 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (trajtimi i kërkesave dhe ankesave për informacion nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania).
- Të vijojë mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga kontrolluesit publik dhe privat të sektorit të kujdesit shëndetësor.
- Të angazhohet në përgatitjen e një rekomandimi unifikues në fushën e shëndetësisë.
- Të monitorojë dhe mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin e arsimit, veçanërisht, në lidhje me masat teknike dhe organizative të marra nga kontrollues të këtij sektori për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale në kontekstin e mësimdhënies online, të diktuar nga situata e shkaktuar nga përhapja e pandemisë Covid-19.
- Të monitorojë dhe mbikëqyrë respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga subjektet kontrolluese që ushtrojnë veprimtari tregtimi të drejtpërdrejtë.
- Të përforcojë bashkërendimin institucional me kontrolluesit publik për të vijuar mbikëqyrjen dhe monitorimin në funksion të rikuperimit të problematikave të konstatuara në raportin e Zyrës së Komisionerit për mbikëqyrjen e kontrolluesve me fokus platformat online, sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe kontrolluesit publik dhe privat të sektorit të kujdesit shëndetësor.
- Të vijojë me dhënien e kontributit në përafrimin e legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me legjislacionin përkatës të BE, konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën e Policisë 2016/680 (realizimin me sukses të projektit të binjakëzimit që po asiston Zyrën e Komisionerit në këtë kuadër).
- Të fuqizojë dhënien e kontributit dhe angazhimin aktiv në grupet ndërkombëtare të punës në kuadër të Asamblesë Globale të Privatësisë (GPA), Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) dhe Konferencës Europiane të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (ECDPA).
- Të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësuëse, trajnuese dhe promovuese për fushat e veprimtarisë, me qëllim ushtrimin në praktikë të të drejtave të qytetarëve, me fokus nxënësit e arsimit parauniversitar, studentët ose përfaqësues të komuniteteve minoritare etnike/kulturore.

Zyra e Komisionerit ka realizuar plotësisht këto 11 rekomandime për vitin 2021. Duke qenë se autoriteti i mbështet objektivat institucionale vjetore, referuar, ndër të tjera, edhe në këto rekomandime, në Raport Vjetor identifikohen të gjitha hapat e marra për përmbushjen e tyre.

XI. VIZIONI

Vizioni ynë është të promovojmë një shoqëri që mbështetet në institucione transparente dhe në kontrollues publik/privat të përgjegjshëm, si vlera themelore, me qëllim arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomiko-social. Ai realizohet vetëm duke zgjeruar bashkëpunimin me këta aktorë që standardet dhe normat rregullatore të kthehen në mundësi për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe jo arsye për t'i kufizuar apo për t'u shmangur prej tyre. Objektivat kryesore për përmbushjen e tij gjatë vitit 2022, me angazhimin dhe përkushtimin e duhur profesional janë:

- Rol aktiv në përmbylljen e procedurave për modernizimin e kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në:
 - miratimin e projektligjit *“Për ratifikimin e Protokollit ndryshues të Konventës për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”*;
 - miratimin e projektligjit *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*.
- Rol aktiv në përmbylljen e procedurave për modernizimin e kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim në:
 - miratimin e projektligjit *“Për ratifikimin e Konventës të Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”*;
 - miratimin e projektligjit *“Për për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014, datë 14.09.2014, “Për të drejtën e informimit”*;
 - miratimin e projektligjit *“Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”* që përaftron Direktivën 2019/1024 të BE.
- Forcimin e kapaciteteve institucionale nëpërmjet realizimit të projekteve me partnerë të ndryshëm, në kuadër të përmirësimeve legjislative, me fokus të veçantë zhvillimet e teknologjisë.
- Bashkëpunimin me qytetarët dhe grupet e interesit për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor dhe rritjen e ndërgjegjësimin në zbatimin e tij.
- Monitorimin dhe mbikëqyrjen proaktive të autoriteteve publike të kategorive të ndryshme për verifikimin e përditësimit të Programit të Transparencës dhe të Regjistratit të kërkesave dhe përgjigjeve, me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtarinë tyre.
- Mbështetje për autoritetet publike në qartësimin e çështjeve mbi interesin publik dhe rastet e kufizimit të dhënies së informacionit, sidomos, përdorimin e konceptit të konfidencialitetit.
- Shtrirjen e sistemeve elektronike AMS dhe REKPD në sa më shumë autoritete publike.
- Forcimin e rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit nëpërmjet trajnimeve periodike dhe mbështetje teknike për institucionet.
- Monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale me fokus masat tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të tyre, veçanërisht, SMSI nga kontrollues publik e privat.
- Monitorimin e rekomandimeve të lëna më herët për kontrollues publik e privat të pasqyruara në Raportin për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit të datës 21.05.2020 dhe gjatë veprimtarisë institucionale të vitit 2021.
- Monitorimin dhe mbikëqyrjen e punës së organeve ligjzbatuese për procesin e përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të detyrave të Zyrës së Komisionerit në ligjet “Për masat

shtesë të sigurisë publike”, “Për kontrollin kufitar”, “Për gjendjen civile” dhe “Për Policinë e Shtetit”.

- Monitorimin e zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust dhe hartimin e Raportit Vjetor.
- Krijimin e Rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale, diktuar nga përmirësimi i legjisllacionit kombëtar të fushës.
- Organizimin e aktiviteteve dhe pjesëmarrjen në iniciativa që i shërbejnë rritjes së ndërgjegjësimit për ushtrimin e të drejtave, me fokus brezin e ri.

Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të kuadrit ligjor në të dy fushat e veprimtarisë në epokën digjitale nxit ndërtimin e besimit reciprok me qytetarët, duke ndikuar vazhdimisht në përmirësimin e mentalitetit dhe kulturës së shoqërisë.